



**Raport**  
**Mbi zbatimin e Planit Kombëtar të**  
**Veprimit për Migracionin**

---

Tiranë, dhjetor 2006

# **Raport**

## **Mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin**

Realizuar nga Instituti European i Tiranës  
në bashkpunim me Qeverinë Shqiptare  
me financim dhe mbështetje të Fondacionit Soros

**Tiranë, mars 2007**

**Ky botim u mundësua me ndihmën e Fondacionit Soros, në zbatim të projektit “Monitorimi i Politikës së Qeverisë për Migracionin”. Përmbajtja e këtij raporti është hartuar nga Ekspertët e Institutit European të Tiranës, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Ministrive dhe Institucioneve të tjera të Shtetit Shqiptar përgjegjës për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin**

**Mendimet e shprehura në këtë Raport janë të autorëve.**

**Përgatitur dhe shkruar nga**

Marta Onorato

Dr. Marine Keta

Igli Totozani

**Redaktor për gjuhën Shqipe**

Dr. Marine Keta

**Përkthyes**

Majlinda Dhespoti

**©Të gjitha të drejtat të rezervuara.**

---

**INSTITUTI EUROPIAN I TIRANËS**

Rr “Brigada VIII” Pallatet Agimi, Sh 21, Ap 362

Tirana, Albania

Tel: + 355 42 73800 Fax: + 355 42 51771

E-Mail ietirana@yahoo.fr

## **FALENDERIM**

Instituti European i Tiranës i shpreh mirënjohje të thellë Fondacionit Soros Tiranë, pa kontributin e të cilit, realizimi i një projekti të tillë do të ishte i pamundur dhe në mënyrë të vecantë Zotit Capajev Gjokutaj dhe Zonjës Rajmonda Duka për besimin që patën në punën dhe ekspertizën e këtij instituti në realizimin me sukses të një ndërmarrjeje të tillë.

Në të njëjtën kohë IET shpreh falenderimet e tij për Qeverinë Shqiptare dhe përfaqësuesit e saj të cilët me kontributin e tyre të pazëvendësueshëm dhanë një ndihmesë të madhe për realizimin e këtij raporti. Në mënyrë të vecantë, falenderojmë për ndihmën e çmuar Znj. Endira Bushati, Znj. Majlinda Hafizi, Z. Pëllumb Nako, Z. Gazmend Barbullushi, Z. Sefedin Xhemalce, Z. Jonian Molla, Znj. Emira Mitrushit, Znj. Luljeta Ikonit.

Së fundi, falenderojmë të gjithë ata që në një mënyrë ose një tjetër ishin gjithmonë të gatshëm për të kontribuar në suksesin e kësaj iniciative.

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

|   |            |
|---|------------|
| <b>HYRJE.....</b>   | <b>6</b>   |
| <b>PAK HISTORI<br/>MBI STRATEGJINË DHE PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR<br/>MIGRACIONIN.....</b> | <b>9</b>   |
| <b>DY FJALË PËR<br/>PROJEKTIN.....</b>  | <b>12</b>  |
| <b>MBI METODOLOGJINË E<br/>PËRDORUR.....</b>  | <b>14</b>  |
| <b>ANALIZË E<br/>PËRGJITHSHME.....</b>  | <b>19</b>  |
| <b>ANALIZË SPECIFIKE PËR CDO MASË.....</b>  | <b>24</b>  |
| <b>REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE.....</b>   | <b>141</b> |
| <b>TABELA E SHKURTIMEVE.....</b>  | <b>145</b> |

## **HYRJE**

1. E sapodalë nga një sistem diktatorial i egër dhe i izoluar, Shqipëria u ballafaqua menjëherë me problemin e Migracionit dhe kjo ndodhi në përmasa të mëdha, kryesisht për sa i takon emigracionit. I shfaqur vrullshëm që me fillimin e viteve 90-të, duke vazhduar në përmasa të jashtëzakonshme pothuaj përgjatë gjithë kësaj periudhe, me gjithë kompleksitetin që e karakterizon këtë fenomen, ai u shndërrua shpejt në një sfidë vërtetë të vështirë për shoqërinë dhe shtetin Shqiptar.
2. Shkaqet e shfaqjes së këtij fenomeni tashmë dihen, sikurse dihen gjithashtu edhe ato që vazhdojnë ta mbajnë gjithmonë në nivele të larta praninë e tij. Ndaj dhe është e kuptueshme që trajtimi i tij edhe pse prioritet i rëndësishëm i të gjitha qeverive shqiptare, nuk ka qenë gjithmonë në nivelet e kërkuara. Duke qenë një fenomen mjaft kompleks edhe përgjigja ndaj tij do të duhet të ishte e tillë, jo gjithmonë e lehtë për këtë vend.
3. Implikimet e tij janë të shumta dhe të shumëllojshme në jetën e vendit, në aspektin e saj social-ekonomik, kulturor dhe politik, por nuk mund të përjashtohen këtu edhe ndikime në sferën e rendit dhe sigurisë. Pikërisht në këto fusha, trajtimi i migracionit do të kërkonte përpunimin dhe më pas zbatimin e një numri reformash të vecanta por dhe të lidhura organikisht mes tyre, reforma që do të kërkonin pjesmarrjen dhe aktivizimin e shumë aktorëve, duke filluar nga qytetari e duke përfunduar me Shtetin dhe organizmat e tij.
4. Sikurse është e lehtë të kuptohet ekzistenca e një fenomeni të tillë dhe sigurisht përmasat e mëdha që e karakterizojnë atë, nuk mund të mos ketë një ndikim të drejtpërdrejtë edhe në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet të cilat janë prekur më shumë, sidomos ato Europiane. Aq më i madh ka qenë ky problem nisur edhe nga fakti se në një pjesë të mirë të tij kemi patur të bëjmë me një emigracion të parregullt, rrjedhimisht vështirësisht të kontrollueshëm.
5. Për këtë arsye, emigracioni ka qenë dhe ka gjasa të mbetet një nga pikat më “të nxehta” në marrëdhënien Shqipëri-Bashkimi Europian. Ky i fundit, duke e konsideruar Shqipërinë si një vend prioritar në luftën kundër migrimin të parregullt e ka inkuadruar këtë problem si një nga më kryesorët në procesin e Stabilizim-Asocimit, proces i cili aktualisht ndodhet në fazën e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.
6. Ishin pak a shumë këto kushte që çuan në aprovimin më 19 Nëntor të vitit 2004 (VKM nr.760) nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të Strategjisë Kombëtare për Migracionin, dokument ky që u bë i mundur nga financimi i Komisionit Europian ( Programi CARDS 2001 ) dhe bashkëfinancimi dhe asistencë teknike e IOM.
7. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti strategjik është “t’i sigurojë Shqipërisë një politikë më gjithëpërfshirëse për migrimin se sa ai i reagimit, kryesisht për të

luftuar rrjedhat e parregullta, një politikë kjo gjithpërfshirëse e bazuar në menaxhimin e migrimit..., për lidhjen e menaxhimit të migrimit dhe zhvillimit të vendit të origjinës në një linjë me orientimet e politikës së përbashkët të integritit të BE-së “<sup>1</sup>

8. I parashikuar për një periudhë kohore pesë vjecare, pra deri më 2010, relizimi i strategjisë do të bëhet i mundur nëpërmjet zbatimit të një dokumenti tjetër të rëndësishëm të aprovuar nga Këshilli i Ministrave me vendim nr. 296, datë 6 qershor 2005 edhe ky i përgatitur dhe përpunuar me financim të Komisionit Europian dhe asistencë teknike të IOM. Ky dokument është Plani i Veprimit për Migracionin, në të cilin parashikohen 66 masa konkrete, të cilat do të duhet të zbatohen kryesisht nga Qeveria Shqiptare por edhe nga aktorë të tjerë të përfshirë në këtë proces.
9. Për të gjitha arësyet që përmendëm më lart, sigurisht në radhë të parë nisur nga vetë natyra e këtij fenomeni, kemi të bëjmë me një Strategji tepër komplekse shumë sektoriale, çka do të thotë se çelsi i suksesit të ndërhyrjes së saj shumëdimensionale do të jetë padyshim koordinimi midis organeve dhe institucioneve të Shtetit Shqiptar dhe këtyre të fundit me shoqërinë civile dhe organizmat dhe institucionet ndërkombëtare si Komisioni Europian, IOM, PNUD etj, etj.
10. Shumica e masave të parashikuara në këtë Plan, për të qënë më të saktë 63 prej tyre, parashikojnë aktivitete dhe veprime të cilat do të duhej të realizoheshin brenda vitit 2006 dhe në shumicën e tyre kërkohet ndërhyrja e koordinuar e më shumë se një institucioni shtetëror.
11. Nisur nga sa përmendëm më lart, Instituti Europian i Tiranës duke e gjetur në përputhje të plotë këtë prioritet kombëtar me prioritetet dhe objektivat e parashikuara në Statutin e tij, duke gjykuar për rëndësinë që ka trajtimi i tij në përputhje me objektivat e Bashkimit Europian në përgjithësi dhe të procesit të integritit Europian të Shqipërisë nga ana tjetër, me ndihmën dhe financimin e Fondacionit Soros, vendosi të ndërhyje dhe rreshtohet si një aktor i ri në këtë proces të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin.

---

<sup>1</sup> “Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit për Migracionin: rruga drejt menaxhimit të Migracionit” Tiranë korrik 2005, f 1

12. Në harmoni të plotë me programin e tij, në përputhje me rolin e pazëvendësueshëm të shoqërisë civile në një vend demokratik, ky Institut do të kontribuojë në mbarëvajtjen e këtij procesi pikërisht nëpërmjet monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit për Migracionit për vitin 2006 me qëllimin për të ndihmuar Qeverinë Shqiptare, institucionet e tjera dhe organizmat e ndryshëm ndërkombëtarë me një instrument të rëndësishëm, leximi dhe përdorimi i të cilit do të ndihmojë në të kuptuarin më mirë e më saktë të situatës dhe gjendjes në të cilën ndodhet realizimi i kësaj politike, vështirësitë e momentit, ndryshimet dhe orientimet e mundshme në të ardhmen...

## **PAK HISTORI**

### **MBI STRATEGJINË DHE PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN**

1. Strategjia Kombëtare për Migracionin u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave më 19 Nëntor të vitit 2004. Ky dokument ishte përgatitur nga Qeveria Shqiptare me financim të Komisionit European, nëpërmjet Programit CARDS 2001 dhe bashkëfinancim dhe asistencë teknike të IOM.
2. Kompleksiteti i fenomenit migrator kërkoi koordinimin e shumë institucioneve dhe organeve shtetërore dhe nga ana tjetër përcaktoi natyrën e dokumentit strategjik, si një strategji komplekse ndërdisiplinore. E njëjta natyrë pune u ndoq edhe për përgatitjen dhe përpunimin e Planit Kombëtar të Veprimit dokument nëpërmjet 66 masave të të cilit do të bëhej i mundur zbatimi i Strategjisë Kombëtare përkatëse.
3. Kështu më 30 Dhjetor të vitit 2004, me anë të Vendimit Nr. 195 të Këshillit të Ministrave, krijohet Grupi i Punës për përgatitjen e këtij plani. I udhëhequr nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, me pjesmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Jashtme, Rendit Publik, Punës dhe Cështjeve Sociale, Financës, Integritimit European, Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Arsimit dhe Shkencës, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, ky grup punoi së bashku për një periudhë katër-pesë mujore.
4. Në përfundim, ai paraqiti draft-Planin e Veprimit për Migracionin, i cili me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 296, u miratua zyrtarisht më 6 Maj të vitit 2005. Që nga ky moment zbatimi i këtij dokumenti do të duhej të zgjaste deri në vitin 2010. Në të njëjtën kohë ai do të duhet të fillonte të zbatohej sic që rasti i masave 42, 39, 38 respektivisht në Maj, Qershor dhe Korrik 2005.
5. Fillimi i këtij zbatimi koinçidoi, sikurse dihet, me nisjen e fushatës elektorale të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të 3 Korrikut. Ndikimi i një aktiviteti të këtyre përmasave, sikurse ka ndodhur rëndom në historinë e Shqipërisë pas viteve 90, si edhe në fusha të tjera nuk do të ishte pozitiv edhe në aplikimin e masave të këtij plani.
6. Rezultati i këtyre zgjedhjeve, ndryshoi pozicionet dhe raportet e forcave në skenën politike Shqiptare: maxhoranca dhe opozita këmbyen vendet dhe bashkë me to edhe programet dhe objektivat, edhe pse duhet pranuar se shtyllat dhe prioritetet kryesore mbetën të njëjtë. Një nga këta prioritete që nuk ndryshuan ishte edhe politika qeveritare ndaj fenomenit migrator. Kështu, për asnjë moment Qeveria e re nuk u deklarua për ndryshim, revizionim apo shfuqizim të dokumenteve kryesore strategjike në këtë fushë.
7. Por nëse nuk ndryshoi qasja ndaj këtij fenomeni, programi i Qeverisë së re parashikonte një sërë reformash të cilat do të preknin vetë strukturën qeveritare.

Kështu, në kuadrin e një qeverie të vogël dhe dinamike, një numër ministrish nuk do të ekzistonin më por do t'i bashkangjiteshin të tjerave. Kështu mund të përmendim, bashkimet e Ministrise se Rendit Publik dhe asaj të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit në një Ministri të Brendshme, të Ministrisë së Ekonomisë me Ministrinë e Industrisë dhe Energjitikës në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, të Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit me Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bashkimin e Turizmit me ish Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve duke e shndërruar në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në këtë kuadër suprimohet edhe Ministri i Shtetit, i cili midis të tjerave kish për detyrë koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit të Migracionit deri në krijimin e Agjencisë Kombëtare të Migracionit dhe Diasporës.

8. Sikurse kuptohet, kjo reformë e rëndësishme ishte vetëm hallka e parë e një zinxhiri reformimesh dhe ndryshimesh strukturore më të imta që do ta pasonin atë. Këto të fundit do të mund të klasifikoheshin si ndryshime strukturore, funksionale dhe hierarkike dhe që do të pasoheshin edhe me largime deri diku masive nga puna.
9. Por gjatë kësaj periudhe u morën edhe një sërë masash të tjera të karakterit strukturor. Kështu u fuqizua Departamenti i Koordinimit në Këshillin e Ministrave, strukturë kjo që do të bënte të mundur koordinimin e të gjitha strategjive ekzistuese sektoriale dhe kombëtare. Është kjo strukturë që po ndjek dhe realizon ngritjen e një sistemi të planifikimit të integruar.
10. Po kështu, më 5 Prill të vitit 2006 me Vendim Nr. 194, Këshilli i Ministrave vendosi “Ngritjen dhe funksionimin e Institutit Kombëtar të Diasporës, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme” institut ky ekzistues, i krijuar me VKM Nr. 216, datë 14.1.1996, por që u shfuqizua nga vendimi i fundit. Marrja e këtij vendimi ishte parashikuar në masat 62, 65 të Planit të Veprimit për Migracionin, por krejt i ndryshëm për nga përmbajtja.
11. Kështu në masën në fjalë ish parashikuar ndërtimi, pranë zyrës së Kryeministrit të Agjencisë Kombëtare për Migracionin dhe Diasporën, strukturë e cila do të duhej të kishte kompetenca politike bërjeje, koordinuese dhe monitoruese. Në vendimin e fundit, Instituti Kombëtar i Diasporës, nuk është në varësi të Kryeministrit, por të Ministrisë së Jashtme dhe kompetencat e tij janë vetëm në kuadrin e hartimit të politikave për migracionin, vlerësimin e përputhshmërisë së strategjive të ndryshme me atë të Migracionit, ndërsa nuk ka kompetenca koordinuese apo monitoruese.
12. Duhet theksuar gjithashtu se, vetëm ditët e fundit, pra rreth shtatë muaj pas krijimit të tij, ky Institut ndërmori iniciativën për krijimin e Bordit të tij Drejtues, parashikuar në pikën 5 të VKM Nr. 194 të Këshillit të Ministrave.

13. Po kështu, një muaj më pas me Urdhër Nr. 115, datë 11 Maj 2006, Kryeministri vendosi « Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Ndërmintor të Migracionit », komitet ky i krijuar me Urdhër Nr. 151 datë 27 Tetor 2003 i cili shfuqizohet. Ky Komitet ka kompetenca kryesisht këshillimore për Këshillin e Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për bashkrendimin e punës dhe organizimin e mbledhjeve është ajo e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
14. Duhet përmendur se takimi i fundit i këtij Komiteti daton në Prill-Maj 2005, kur u bë i mundur aprovimi paraprak i Planit të Veprimit për Migracionin. Gjithmonë në fuqi që nga ajo periudhë, ai nuk është mbledhur më me gjithë detyrimin ligjor që kjo të ndodhte jo më pak se një herë në gjashtë muaj.
15. Është e rëndësishme të theksohet së fundi se Qeveria Shqiptare, në të gjitha këto reforma është nisur nga objektivi për të reduktuar shpenzimet publike, sidomos ato administrative.
16. Pak a shumë në këtë kontest u përpunua, miratua dhe filloi zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit dhe Planit të Veprimit përkatës, monitorimi i të cilit ishte dhe objekt i punës së Ekspertëve të Institutit Europian të Tiranës, sigurisht për ato masa, aktivitetet e të cilave ishin parashikuar të realizoheshin brenda vitit 2006.

## DY FJALË PËR PROJEKTIN

### “Monitorimi i Politikës së Qeverisë për Migracionin”

#### Financues: Fondacioni Soros

1. Një nga objektivat e parashikuara ne Statutin e IET është "realizimi i studimeve, kërkimeve, organizimi i konferencave, takimeve dhe bisedave me problematikë ekonomike, sociale, kulturore europiane si dhe të atyre që kanë të bëjnë me integrimin e Shqipërisë në Europë". Nuk ka dyshim se realizimi i një studimi mbi implementimin e politikës për migracionin të Qeverisë Shqiptare në perspektivën e integritit të Shqipërisë në Europë është në koherencë të plotë me këto objektiva.
2. Strategjia Kombëtare e Migracionit, si shumë dokumente të tjerë strategjikë të Qeverisë nuk është një dokument statik, por dinamik. Si i tillë, është e nevojshme ndjekja dhe monitorimi i vazhdueshëm i tij. Për këtë arsye, IET është i ndërgjegjshëm për nevojën që ky projekt të mos ngelë një përpjekje e izoluar ; me mundësitë e tij apo edhe me ndihmën e donatorëve të tjerë, ai do të vazhdojë të ndjekë dhe monitorojë periodikisht politikën e qeverisë në fushën e migracionit.
3. Që prej vitit 2002, Qeveria Shqiptare ka parashikuar përpunimin e një Strategjie Kombëtare për Migracionin, projekt që ka mundur të realizohet gjatë viteve 2004 - 2005 në sajë të financimit të Komisionit European (nëpërmjet programit CARDS) dhe Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit. Më 19 Nëntor 2004, Këshilli i Ministrave aprovoi Strategjinë Kombëtare si një dokument ku përfshihet politika e sektorit dhe më 6 Maj 2005, me anë të Vendimit Nr. 296, aprovoi një plan veprimi të detajuar që ishte frut i bashkëpunimit të një numri të madh ministrish dhe institucionesh të përfshira në përpunimin e politikës së këtij sektori.
4. Plani i veprimit mbulon kryesisht fushat e shkaqeve të migracionit, të mbrojtjes së emigrantëve shqiptarë jashtë Shqipërisë, të përmirësimit të shërbimeve konsullore nga ana e konsullatave dhe ambasadave shqiptare, ndërtimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në një diasporë të organizuar, organizimin e një politike adekuate për emigracionin ekonomik, zhvillimin e një politike për rikthimin dhe ripranimin e emigrantëve ilegalë shqiptarë dhe të qytetarëve të vendeve të tretë dhe zhvillimin e kuadrit të nevojshëm legjislativ dhe institucional për vënien e tij në jetë.
5. Në total planveprimi përmban 66 masa dhe elementët e nevojshëm për vënien në jetë të tyre. Ndërmjet këtyre të fundit është parashikuar krijimi i një Agjencie Qeveritare, e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me Kryeministrin e që do të ketë në ngarkim çështjet e migracionit në kuptimin e tyre më të gjerë (emigracion, imigracion, diasporë). Aktualisht, për shkak të ndryshimit të qeverisë pak kohë më parë, organizmi përkohësisht i ngarkuar me këtë detyrë (Ministri i Shtetit),

nuk ekziston më. Pa dyshim, kjo gjë e ka vështirësuar realizimin e masave të përfshira në këtë plan, koordinimin e tyre dhe mundësinë e Qeverisë për të reaguar në kohë ndaj vonesave të mundshme ose efektive në zbatimin e këtij plani.

6. Ky projekt ka për qëllim të verifikojë zbatimin e politikës së Qeverisë Shqiptare në fushën e migracionit (në të dy aspektet, atë të emigracionit dhe të imigracionit) nëpërmjet
  - studimit të strategjisë aktuale për migracionin dhe të planveprimit të saj ;
  - verifikimit të masave të ndërmarra dhe të impaktit të tyre në këtë sektor ;
  - verifikimit të vonesave në lidhje me masat që duhen marrë dhe arsyet e ketyre vonesave ;
  - analizimit të masave të parashikuara dhe të kushteve ekzistuese për realizimin e tyre ;
  - hartimit të konkluzioneve dhe rekomandimeve për zhvillimin e politikës në këtë sektor.
7. Qëllimi themelor i projektit ka të bëjë me forcimin e aftësisë së Qeverisë për të zhvilluar dhe zbatuar politikën e adpotuar për një administrim më të mirë të fenomenit migrator.
8. Përsa u përket objektivave më specifike, mund të përmendim
  - Krijimi i një kuadri të plotë të politikës aktuale të Qeverisë në fushën e migracionit.
  - Analizimi i rezultateve që jep një politikë e tillë.
  - “T”i ofrojmë” Qeverisë një instrument për të përmirësuar dhe aktualizuar politikat e saj.
9. Rezultatet e pritura me këtë rast janë;
  - Kuadri i plotë i politikës migratore të Qeverisë.
  - Krijimi i një instrumenti të dobishëm që mund t'i vijë në ndihmë Qeverisë dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar politikat në këtë sektor.
  - Zhvillimi i një politike gjithnjë aktuale në këtë sektor.
10. Përfituesi i drejtpërdrejtë i projektit është Qeveria Shqiptare, në mënyrë të vecantë Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme. Përfitues jo të drejtpërdrejtë të projektit do të jenë të gjithë ata individë (shqiptare dhe të huaj) të përfshirë në fenomenin migrator.

## MBI METODOLOGJINË E PËRDORUR

1. Qëllimi i këtij studimi, ishte vlerësimi dhe monitorimi i politikës së Qeverisë Shqiptare në fushën e Migracionit. Në mënyrë të vecantë bëhet fjalë për monitorimin e zbatimit nga ana e institucioneve shtetërore të Strategjisë Kombëtare për Migracionin, dokumenti kryesor strategjik që shpreh në të njëjtën kohë vizionin dhe orientimin shtetëror në trajtimin e këtij fenomeni tepër prezent dhe të rëndësishëm në jetën e vendit dhe më gjerë.
2. Në përputhje të plotë me qëllimin e mësipërm, duke e konsideruar Planin Kombëtar të Veprimit për Migracionin dokumentin zbatues të Strategjisë së mësipërme, IET përcaktoi si objektivin kryesor të kërkimit nivelin e realizimit të masave konkrete të këtij plani deri në momentin e zhvillimit të këtij studimi, që koinçidon me periudhën Nëntor - Dhjetor 2006.
3. Nisur nga objektivi i kërkimit tonë monitorues ne përcaktuam dhe përzgjedhëm kampionin e kërkimit tonë i cili në rastin tonë ishte ai grup i ngushtë personash funksionarësh shtetërore, të cilët për shkak të detyrës së tyre dhe në përputhje me kompetecat, ishin përfaqësuesit-përgjegjës të institucioneve përkatëse të përfshirë në trajtimin e problemit migrator dhe zbatimin e PKVM në veçanti.
4. Sigurisht për një qasje sa më të plotë ndaj objektivit tonë, kampioni i përzgjedhur do të duhej të kishte qenë ndoshta më i gjerë, duke përfshirë në të edhe kategori të tjera institucionesh apo edhe qytetarësh të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo ishin dhe janë të lidhur me problemin migrator. Një gjë e tillë ka qenë e pamundur për shkak të kufizimeve kohore dhe financiare, por mbi të gjitha për shkak të vetë objektivit të synuar d.m.th të monitorimit të masave të PKVM, ç'ka vetvetiu reduktonte përmasat e grupit të përzgjedhur.
5. Në këtë kuadër në përputhje me PKVM, institucionet përgjegjëse, përfaqësuesit e të cilëve bënë pjesë në grupin tonë, së bashku me masat që do të duhet të realizonin ishin si më poshtë :
  1. Kabineti i Zv/Kryeministrit, për masat 62, 65
  2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për masat 2-4, 6, 8-9, 17, 25, 30, 39-40, 42-44, 47, 54-57, 58-60, 62-63
  3. Ministria e Punëve të Jashtme, për masat 12-14, 18-30, 42-43, 45-46, 49-51, 57-60, 62-63
  4. Ministria e Brendshme, për masat 5, 7, 10-11, 13, 41, 53, 58-60, 62-63
  5. Instituti Kombëtar i Diasporës, për masat 32-33, 35-36, 39, 66
  6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për masat 16, 36, 47-48, 58, 64
  7. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për masat 14-17-37
  8. TVSH, për masat 16-17, 34
  9. Ministria e Integritimit, për masat 13, 28
  10. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për masat 30, 31
  11. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, për masën 47

12. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për masën 2
  13. Avokati i Popullit, për masën 23
  14. Komisioni Qëndror Elektorale, për masën 58
  15. ITAP, për masën 61
6. Në përputhje me natyrën e objektivit të synuar u përcaktuan si më të racionale, rezultative dhe efikase dy lloje metodash kërkimi : ajo dokumentare dhe ajo aksionit të kërkimit.
  7. Fillimi dhe një pjesë e mirë e kohës së parashikuar për zhvillimin e projektit iu kushtua kërkimit, studimit dhe analizës së dokumenteve zyrtare të fushës. Kështu, për këtë qëllim, ndër dokumentet kryesore mund të përmendim : Strategjinë Kombëtare për Migracionin, Planin Kombëtar të Veprimit për Migracionin, akte të ndryshëm të aprovuar nga Parlamenti Shqiptar, Këshilli i Ministrave apo Ministrinë e linjës, botime të publikuara nga organizatat ndërkombëtare etj, etj.
  8. Përzgjedhja e dokumenteve të mësipërme u kushtëzua nga raporti direkt që ato kishin me përmbajtjen e PKVM, realizimi i të cilit përbënte objektivin e monitorimit. Në mënyrë të vecantë, përveç njohjes në kuptim të përgjithshëm të gjëndjes së realizimit, dokumenta të caktuar do të ndihmonin drejtpërdrejt në monitorimin e masave konkrete ndër aktivitetet e të cilave parashikohej aprovimi i aktit përkatës.
  9. Periudha e dytë e monitorimit u karakterizua nga përdorimi i detyrueshëm i teknikave të aksionit të kërkimit dhe kjo në varësi të natyrës së objektivit të synuar dhe në mënyrë të vecantë sepse monitorimi i realizuar nga ekspertët e IET ishte absolutisht i pari i plotë i kryer në lidhje me zbatimin e PKVM, pra në një terren plotësisht bosh.
  10. Në këtë kuadër u konsiderua si më efikas organizimi i kryqëzuar takimesh individuale dhe në grup. Kështu, për sa i takon të parave takimet e zhvilluara ishin të tipit direkt dhe me pyetje pak a shumë të hapura. Në këtë mënyrë bëhej e mundur përcaktimi paraprak i të dhënave të synuara, saktësia dhe precizioni i tyre dhe nga ana tjetër ruajtja e një koherence sa më të madhe në përgjigjet e bashkëbiseduesve.
  11. Për këtë qëllim u përgatitën paraprakisht pyetësore precize për secilin institucion, kuptohet për masat për realizimin e të cilave ai ishte përgjegjës. Pyetjet e parapërgatitura synonin në radhë të parë përgjigje precize lidhur me realizimin ose jo të masave konkrete, të aktiviteteve të parashikuara dhe shkaqet e mos realizimit. Pyetjet u zgjodhën posaçërisht të hapura për t'i dhënë mundësi të intervistuarve të përgjigjeshin lirshëm (megjithëse pyetjet ishin pak a shumë të përcaktuara qartë dhe me përmbajtje drejtpërsëdrejti të lidhur me realizimin ose jo të masës konkrete apo të aktiviteteve të parashikuara për zbatimin e saj). U përdorën dy lloj intervistash : pyetësorë me shkrim dhe intervista direkte.

12. Takimet në grup synonin ballafaqimin e të dhënave të marra individualisht me secilin përfaqësues institucioni dhe të kuptuarin më mirë të kontekstit në të cilin po bëhej i mundur zbatimi i PKVM. Për këtë qëllim u organizuan dy takime të tilla në datat 13 dhe 24 Nëntor 2006.
13. Për sa i takon vlerësimin të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit si tregues kryesorë mund të përmëndim : përfshirja e aktiviteteve të parashikuara për realizimin e masave në programet vjetore të punës së institucioneve përgjegjëse, parashikimi i fondeve të nevojshëm për zbatimin e masave në buxhetet respektive të institucioneve apo nga ndihma e donatorëve të huaj, produktet e prekshme të aktiviteteve të parashikuara si dhe të gjithë treguesit e parashikuar për çdo masë në vetë planin e veprimit.
14. Ky kërkim monitorues u ndesh që në fillim me një sërë vështirësish të natyrave të ndryshme, shkaqet kryesore të të cilave gjenden si në metodologjinë e përdorur ashtu edhe jashtë saj.
15. Duke filluar nga këta të fundit mund të përmëndim si vështirësi të parë dhe jo pak të rëndësishme faktin se në fushën në të cilën shtrihet kërkimi, pra në ata të migrimit nuk gjendeshin raporte të tjerë të kësaj natyre në lidhje me zbatimin e PV. Kjo vështirësi punën tonë deri në njëfarë mase.
16. Një tjetër problem jo i vogël shkaktohej edhe nga vështirësia me të cilën do të jenë ndeshur edhe të tjerë për të siguruar informacion shtetëror lidhur me zhvillimet më domethënëse, sic mund të jetë faza në të cilën ndodhet një projektligj apo VKM. Në përgjithësi me këtë vështirësi u përballëm përgjatë gjithë zhvillimit të projektit.
17. Një tjetër kufizim ishte edhe koha e shkurtër e zhvillimit të projektit. Kjo duhet kuptuar drejt : nuk ka të bëjë me shpejtësinë e procesit të implementimit të PV por kryesisht me realizimin e takimeve. Kështu ishte jo e lehtë të kontaktoje përfaqësuesit dhe kjo për arsye të ndryshme, por nisur nga numri i madh i takimeve që duhej të zhvilloheshin kuptohet që koha kushtuar këtij aktiviteti ishte e pamjaftueshme.
18. Po kështu, financimi i projektit nga një grant i vogël, kushtëzonte në një farë mënyre objektin e kërkimit. Mundësi më të mëdha financiare do të kishin kontribuar në zgjerimin e objektit të kërkimit, duke mos e reduktuar kërkimin në thjesht zbatim apo jo të masave, por duke favorizuar në maksimum edhe impaktin e zbatimit të këtyre masave. Për shembull do të ishin tepër të vlefshme vizita në pikat kufitare, në konsullatat tona në vendet fqinje etj, etj, aktivitete këto që do të ndihmonin në të kuptuarin më mirë edhe të kontestit në të cilin po zbatohet plani në fjalë.

19. Kufizime të tjera që ndikuan në këtë kërkim monitorues patën si shkak vetë metodologjinë e zgjedhur, e cila gjithsesi ishte më efikasja dhe më e përshtatshme në lidhje objektive dhe synuar. Kështu, gjetja dhe azhurnimi me dokumentet e ndryshëm shtetëror të lidhura direkt me zbatimin e PV nuk ishte një ndërrmarje e lehtë. Në jo pak raste është humbur shumë kohë për evidentimin dhe gjetjen e tyre.
20. Por vështirësia më e madhe ndaj kërkimit u kushtëzua nga takimet intervistues. Sikurse dihet, vetë intervistimi, duke filluar që nga përgatitja e pyetjeve gëzon disa kufizime të rëndësishme të vetë natyrës së tij. Në rastin tonë këto vështirësi shtoheshin edhe nga disa fakte të tjera mjaft të rëndësishme: statusi i intervistuesve, objektivi i kërkuar në një fushë që përkufizohet si një politikë publike mjaft sensibil, ecuria e punës së secilit prej të intervistuarve, natyra personale etj, etj.
21. Jo rastësisht idea e të qenit, apo të paktën të ndjerit të kontrolluar nga individë, “legjitimiteti” i punës së të cilëve duke mos qenë pjestare të shtetit dhe mbi të gjitha superiore në një vijë hirarkike, shkaktonte të parin “bllokim” dhe si pasojë një përgjigje me sinjeritet të cunguar, që krijonin në vetvete një vështirësi jo të vogël në konkluzionin përfundimtar për çdo masë të analizuar.
22. Jo rrallë u desh të ngulmohej në rolin bashkëpunues të shoqërisë civile sic ishte edhe rasti në fjalë për të vendosur ura besimi me bashkëbiseduesit por gjithsesi jo gjithmonë e suksesshme edhe kjo si përpjekje. Po kështu fusha sensibil në të cilën po zhvillohej kërkimi nuk ndihmonte gjithmonë. Jo rrallë në disa bashkëbisedues intervistat vështirësoheshin nga shqetësimi se mos të dhënat binin “në dorë” të opozitës, sigurisht, rezultat ky i të mos kuptuarit të binomit “politike publike”.
23. Një tjetër kufizim shkaktohej edhe nga fakti i thjeshtë i mungesës së koordinimit të punës nga strukturat shtetërore. Kështu ka qëlluar të ishin realizuar masa të caktuara të parashikuara në plan por personi përgjegjës nuk dinte gjë etj, etj.
24. Vërtetësia e këtij monitorimi qëndron në rradhë të parë tek vetë parimi mbi të cilin u ngrit dhe funksionoi ai. Ky monitorim u konceptua, ndërtua dhe u realizua bazuar në besimin ndaj ndershmërisë profesionale të të intervistuarve-përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të përfshira në trajtimin e fenomenit migrator. E megjithatë për të arritur sa më pranë të vërtetës përgjatë verifikimit të zbatimit të masave të parashikuara në planin e veprimit, u desh të thirrej për ndihmë aplikimi i pyetësorëve të kryqëzuar për secilën masë, gje që lehtësohej edhe nga vetë natyra e masave që në të shumtën e kishin të parashikuar bashkëpunimin e më shumë se një institucioni.
25. Së fundi, pavarësisht nga vështirësitë dhe kufizimet e hasura përgjatë zbatimit të projektit raporti i përgatitur ka një rëndësi mjaft të madhe:


Së pari, ai do të jetë një instrument mjaft i vlefshëm për qytetarin, sepse do të mund të sensibilizojë qeverinë në punën e saj të realizimit të detyrimeve të parashikuara në këtë plan,

Së dyti, do të lehtësojë punën e Qeverisë, jo vetëm duke i dhënë një instrument që i qartëson gjendjen reale të trajtimit të fenomenit migrator, por mbi të gjitha duke i dhënë asaj një numër të konsiderueshëm rekomandimesh që do të mund të lehtësojnë sadopak punën e ardhshme.

Së treti dhe së fundi, ky projekt tregoi se me pak financim, me një staf tepër të vogël, qeveria dhe strukturat e saj do të mund të monitorojnë edhe vetë në të ardhmen politikën publike realizimi i të cilave ndikon drejtpërdrejt në jetën dhe mirëqënien e qytetarit.

## ANALIZË E PËRGJITHSHME

1. Nga 66 masa të parashikuara në planin e veprimit 63 do të duheshin të realizoheshin ose të paktën zbatimi do të duhej të kish filluar brenda Vitit 2006. Janë pikërisht këto 63 masa të cilat përbënë objektin e punës sonë pra edhe të raportit.
2. Deri tani, periudhë që koinçidon me mbylljen e monitorimit, vetëm 17 masa janë realizuar ose thënë ndryshe 27 %, 12 janë realizuar pjesërisht ose 19%, që do të thotë se 54 % ose ndryshe 34 masa nuk janë realizuar akoma sipas parashikimit të Planit të Veprimit. Ndërsa për sa i takon aktiviteteteve, janë realizuar vetëm 33 prej tyre ose 28%, janë realizuar pjesërisht 9 prej tyre ose 8% dhe nuk janë realizuar 77 ose 64%.



3. Midis arsyeve të ngritura për një nivel kaq të ulët të zbatimit mund të përmendim faktin shqetësues që nga 15 Ministri apo Institucione të konsultuara 8 prej tyre nuk ishin në dijeni të ekzistencës së Strategjisë dhe Planit të Veprimit apo në rastin më të mirë të përmbajtjes së tyre, që do të thotë as më shumë e as më pak se 53 % e këtyre institucioneve. Shkak kryesor i një situatë të tillë duhet të kërkohet në reformën që u ndërмор nga Qeveria Shqiptare që në ditët e para te saj, reformë që synoi reduktimin e Qeverisë.
4. Kështu, në kuadrin e një Qeverie të vogël dhe më dinamike, një numër ministrish nuk do të ekzistonin më por do t'u bashkangjiteshin të tjerave, si p.sh bashkimet Ministri e Rendit Publik dhe ajo e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit në Ministri të Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë me Ministrinë e Industrisë dhe Energjitikës në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, të Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit me Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bashkimin e Turizmit me ish Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve duke e shndërruar në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në këtë kuadër suprimohet edhe Ministri i Shtetit, i cili midis të tjerave kish për detyrë koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit të Migracionit deri në krijimin e Agjencisë Kombëtare të Migracionit dhe Diasporës.
5. Sikurse kuptohet kjo reformë e rëndësishme ishte vetëm hallka e parë e një zinxhiri reformimesh dhe ndryshimesh strukturore më të imta që do ta pasonin atë. Këto të fundit do të mund të klasifikoheshin si ndryshime strukturore, funksionale dhe hierarkike dhe që do të pasoheshin edhe me largime deri diku masive nga puna. Në këtë kuadër nuk mbeti pa u prekur edhe stafi që prej disa vitesh ish marrë me përgatitjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit gjë kjo që ndodhi si rezultat i eliminimit, bashkimit apo ndryshimit të strukturave.
6. Stafi që sot merret me problemin e Migracionit në përgjithësi dhe zbatimin e Planit të Veprimit në vija të përgjithshme nuk është më ai i pari dhe përvec kësaj ai është reduktuar. Zvogëlimi i tij, pothuajse në të gjithë ministritë e përfshira në zbatimin e strategjisë është një pikë kritike për tu marrë në konsideratë, në mënyrë të vecantë sepse zhvillimi i një politike serioze në fushën e Migrimit kërkon, ashtu sic parashikohet në frymën e strategjisë, rforcim të departamenteve të ndryshëm që trajtojnë këtë fenomen dhe jo dobësimin e tyre.
7. Pasojë e kësaj situatë janë edhe rezultatet e sapopërmendura lidhur me njohjen e këtyre dokumenteve apo të përmbajtjes së tyre. Por në ndonjë rast, funksionarët e rinj të sapoardhur, edhe pse e padeklaruar asnjëherë publikisht nga qeveria e re, vinin në dyshim vetë vlefshmërinë e këtyre dokumenteve duke i konsideruar ata si produkte të një qeverie të kaluar, pra të "pavlefshëm", fakt ky alarmant, që tregon deri diku se sa zbatohet në Shqipëri parimi i vazhdimësisë së Shtetit.

8. Nga ana tjetër, shumica e institucioneve pranuan mungesën e ndjeshme të koordinimit (pothuajse inekzistent) midis organizmave përgjegjës dhe një mungese totale të një institucioni zyrtarisht të ngarkuar me koordinimin global të strategjisë, nëse nuk konsiderohet koordinimi “de facto” nga ana e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Duhet pranuar që në fillim se ekzistenca e një strukture koordinuese dhe monitoruese për zbatimin e Planit të Veprimit, duke qenë ky një moment përcaktues për suksesin e politikës së kësaj fushe ishte planifikuar në vetë këtë plan, pikërisht në masat 62 dhe 65.
9. Kështu në masat në fjalë ish parashikuar ndërtimi, pranë zyrës së Kryeministrit të Agjencisë Kombëtare për Migracionin dhe Diasporën, strukturë e cila do të duhej të kishte kompetenca politike bërjeje, koordinuese dhe monitoruese. Ky vendim u mor nga qeveria e re por krejt i ndryshëm nga parashikimi i Planit. Kështu, më 5 Prill të vitit 2006 me Vendim Nr. 194 Këshilli i Ministrave vendosi “Ngritjen dhe funksionimin e Institutit Kombëtar të Diasporës, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme” institut ky ekzistues, i krijuar me VKM Nr. 216, datë 14.1.1996, por që u shfuqizua nga vendimi i fundit.
10. Me këtë vendim, Instituti Kombëtar i Diasporës, nuk është në varësi të Kryeministrit, por të Ministrisë së Jashtme dhe kompetencat e tij janë vetëm në kuadrin e hartimit të politikave për migracionin, vlerësimin e përputhshmërisë së strategjive të ndryshme me atë të Migracionit dhe nuk ka të tilla koordinuese apo monitoruese. Duhet theksuar gjithashtu se, vetëm ditët e fundit, pra rreth shtatë muaj pas krijimit, ky Institut ndërmori iniciativën për krijimin e Bordit të tij Drejtues, parashikuar në Pikën 5 të VKM Nr.194 të Këshillit të Ministrave. Pavarësisht nga kjo është për tu theksuar se sot mungon, në kundërshtim me frymën e strategjisë një organ i caktuar për koordinim të punës dhe aktivitetit të organizmave të përfshira në zbatimin e Planit dhe nëpërmjet tij të Strategjisë.
11. Vetëm një muaj pas marrjes së këtij vendimi, me Urdhër Nr. 115, datë 11 Maj 2006, Kryeministri vendosi «Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Ndërmintor të Migracionit» komitet ky i krijuar me Urdhër nr. 151 datë 27 Tetor 2003 i cili shfuqizohet. Ky komitet ka kompetenca kryesisht këshillimore për Këshillin e Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për bashkërendimin e punës dhe organizimin e mbledhjeve është ajo e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
12. Duhet përmendur se takimi i fundit i këtij Komiteti daton në Prill-Maj 2005, kur u bë i mundur aprovimi paraprak i Planit të Veprimit për Migracionin. Gjithmonë në fuqi, që nga ajo periudhë ai nuk është mbledhur më me gjithë detyrimin ligjor që kjo të ndodhte jo më pak se një herë në gjashtë muaj. Pavarësisht nga vendimi i fundit ky Komitet ka qenë gjithmonë ekzistues, ndaj mos mbledhja e tij ka ndikuar dukshëm në rezultatet e arritura.

13. Çështja e koordinimit tërheq vëmendjen tonë gjithashtu edhe për sa i takon çështjes së përafrimit të strategjive të ndryshme me Strategjinë për Migracionin siç parashikohet nga masa nr 1. Kush do ta bëjë të mundur këtë?
14. Një problem tjetër i madh që ka ndikuar dukshëm në mosrealizimin e masave të parashikuara për këtë periudhë ka qenë pa dyshim edhe ai i mungesës së fondeve. Mungesa e tyre është ngriur dhe pranuar si një çështje sensibil edhe pse, është evidente se aprovimi i Planit të Veprimit me vendim qeverie në maj 2005, implikonte, përveç të tjerave, edhe një zotim financiar nga ana e kësaj të fundit.
15. Nuk duhet neglizhuar fakti se ky angazhim është pjesë e marrëdhënies Shqipëri-BE dhe se kjo e fundit ka aprovuar tashmë rreth një milion euro në kuadrin e Programit CARDS, për zbatimin e Strategjisë, angazhim ky që kërkon reciprocitetin e tij nga Qeveria Shqiptare, aq më tepër që kjo e fundit është përgjegjësj kryesore për trajtimin e këtij fenomeni në Shqipëri. Përveç kësaj, shtyrja e zbatimit të projektit « Mbështetje për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin » në kuadrin e Programit CARDS 2004, ka dobësuar mundësinë e Shtetit të zbatonte jo vetëm masën nr. 1, por edhe masa të tjera.
16. Së fundi por jo më pak e rëndësishme është çështja e mungesës së evidentimit të një organizmi monitorues për strategjinë i cili sipas masës 65 do të duhet të ishte Instituti apo Agjencia Kombëtare për Diasporën dhe Migracionin. Ky problem mund të shkaktojë në të ardhmen faza stanjacioni përgjatë zbatimit të strategjisë. Është edhe kjo një situatë që ka ndikuar dukshëm në rezultatet e paraqitura më lart.
17. Pjesa e dytë përfshin një analizë të secilës masë. Kështu për secilën masë janë parashikuar tre rubrika:
- gjendja e zbatimit,
  - konsiderata specifike mbi arësyet e moszbatimit ose mbi rezultatet e arritura nëpërmjet zbatimit mbi bazën e sugjerimeve të marra nga Ministrinë apo Institucionet e përfshira në proces dhe sugjerimeve të vetë ekspertëve
  - dhe rekomandimet e përpunuara nga ekspertët, të cilat parashikojnë veprime apo aktivitete që duhen realizuar për një zbatim më të mirë e më të shpejtë të Planit të Veprimit, thënë ndryshe të arrijës dhe realizimit të një politike më efektive.

## **ANALIZË SPECIFIKE PËR CDO MASË**

### ***A. Lufta kundër migracionit të paligjshëm***

#### ***A.1 Lufta kundër shkaqeve të emigracionit***

##### ***Masa 1***

Përjasja e strategjive të tjera ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare për Migracionin.

##### ***Aktiviteti***

Te bëhet vlerësimi i strategjive ekzistuese apo që do të miratohen në të ardhmen nga Instituti Kombëtar i Diasporës dhe Migracionit me qëllim që sigurohet përputhje me Strategjinë Kombëtare për Migracionin.

##### ***Kërkesa paraprake***

-

##### ***Institucioni përgjegjës***

Instituti Kombëtar i Diasporës dhe Migracionit

##### ***Institucioni zbatues***

Instituti Kombëtar i Diasporës dhe Migracionit

##### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

2006-2010

##### ***Burimet njerëzore***

Burimet ekzistuese

##### ***Buxheti në total***

Nuk ka nevojë për buxhet

##### ***Treguesit (nëse ka)***

Raporte vjetore

##### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

##### ***Konsiderata***

VKM nr 194, datë 5 prill 2006, parashikon krijimin e IKD, nën MPJ, dhe i njeh kompetenca kryesisht për Diasporën. Instituti i sapokrijuar është ngarkuar, përveç detyrave të tjera, me përafrimin e strategjive ekzistuese me SKM. Megjithatë, IKD nuk ka përfunduar akoma asnjë vlerësim specifik, që ishte parashikuar si aktiviteti kryesor i kësaj mase. IKD, aktualisht, trajton vetëm çështje që kanë të bëjnë me diasporën dhe nuk ka një vizion global mbi SKM. Nga ana tjetër, pas krijimit të ri, IKD që ekzistonte edhe

më parë (u krijua, në fakt më 1996), ka pësuar një reduktim të personelit të tij, i cili ka kaluar nga gjashtë funksionar në katër të tillë (tre specialist dhe drejtori) dhe nuk ka, aktualisht, burime njerëzore të mjaftueshme për të trajtuar detyrat e reja. Gjithashtu, është e rëndësishme të nënvizohet edhe se IKD nuk ka një buxhet të pavarur, por aktivitetet e tij janë përfshirë në buxhetin e MPJ. Kompleksiteti i SKM, kërkon, pa dyshim, përafrimin e saj me strategjitë ekzistuese, që duket rruga më e saktë për të evituar mbivendosjen dhe krijimin, në të kundërt, të sinergjive të rëndësishme.

### ***Rekomandime***

1. Rekomandohet që Komiteti Ndërmintor për Migracionin duhet të qartësojë se cili organizëm është ngarkuar për zbatimin e këtij aktiviteti. Në rast se IKD konfirmohet si organizmi përgjegjës, ai duhet të pajiset me burimet financiare dhe njerëzore për të realizuar këtë detyrë;
2. Organizmi përgjegjës duhet të veprojë në bashkpunim me strukturën e re të Qeverisë për Sistemin e Planifikimit të Integruar;

## **MASA 2**

Marrja e masave me qellim uljen fluksit te migracionit ne zonat rurale nepermjet krijimit te lehtesirave per gjallerimin e sektorit bujqesor ne vend.

### ***Aktiviteti***

1. Kryerja e nje raporti vleresues mbi emigrimin ne zonat rurale dhe identifikimi i zonave me emergjente per gjallerimin e sektorit bujqesor.
2. Parashikimi i masave konkrete ne Strategjine për Zhvillimin Rural me qellim nxitjen e punesimit ne sektorin bujqesor ne vend.

### ***Kerkesa paraprake***

Miratimi dhe zbatimi i Strategjise per Zhvillimin Rural

### ***Institucioni pergjegjes***

1. MPCS
2. MB

### ***Institucioni zbatues***

- 1.MPCS/MB
- 2.MB

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

- 1.2006
- 2.2007-2010

### ***Burimet njerezore***

1. Tre (3) eksperte per kryerjen e studimit
2. Burimet ekzistuese

### ***Buxheti ne total***

1. 30.000 euro
2. Per tu identifikuar pas kryerjes se raportit

### ***Treguesit (nëse ka)***

1. Raporti vleresues ne 2006
2. Renie e numrit te emigranteve ne keto zona

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. Jashtë objektit të Raportit

### ***Konsiderata***

Zbatimi i kësaj mase kërkon bashkëpunimin ndermjet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Bujqësisë. Ky bashkëpunim ka munguar dhe përveç kësaj, Ministria e Bujqësisë nuk e ka parashikuar këtë masë në

programin e saj vjetor, për rrjedhojë nuk ka bërë parashikimin buxhetor përkatës. Për pasojë nuk është përpiluar asnjë raport vlerësimi. Ekspertët e IET konsiderojnë si vecanarisht shqetësues faktin se Ministria e Bujqësisë injoronte ekzistencën e Strategjisë dhe për më tepër që ky dokument perceptohet si një « krijesë » e Qeverisë së kaluar, për rrjedhojë as i detyrueshëm për stafin e ri, as i rëndësishëm për planifikimin e tyre të punës. Një qasje e tillë duket në kundërshtim të hapur me parimin e vazhdimësisë së Shtetit, që do të duhet të ishte në bazë të një demokracie efiçente.

### ***Rekomandime***

- 1.** Komiteti Ndërministror i Migracionit duhet edhe njëherë të deklarojë vullnetin e tij për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin.
- 2.** Ministria e Bujqësisë duhet sa më parë të rishikojë programin e saj vjetor duke përfshirë aktivitetet e parashikuara nga PKVM dhe të parashikojë fondet e nevojshme për zbatimin e tyre (mund të kërkohet me këtë rast ndihma e donatorëve si psh, nga Programi Cards 2004).
- 3.** Duhet të parashikohen kontakte dhe takime periodike midis MPCSSHB dhe MB.

### **MASA 3**

Vleresimi i mundesive konkrete qe ofron Strategjia për Punësimin dhe Formimin Profesional per emigrantet e kthyer.

#### ***Aktiviteti***

1. Kryerja e nje raporti vleresues mbi mundesite e formimit profesional qe ofrohen aktualisht per emigrantet e kthyer dhe mbi nevojat dhe mangesite ekzistuese.
2. Parashikimi i masave konkrete ne Strategjine per Punesim dhe Formim Profesional per rritjen e nivelit te punesimit ne vend te te kthyerave.

#### ***Kerkesa paraprake***

Perfundimi i raportit vleresues

#### ***Institucioni pergjegjes***

MPCS

#### ***Institucioni zbatues***

MPCS

#### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

1. 2006
2. 2007-2010

#### ***Burimet njerezore***

1. Tre (3) Eksperte
2. Per t'u identifikuar pas kryerjes se studimit

#### ***Buxheti ne total***

1. 30 000 euro
2. Mbeshetur ne nevojat e identifikuara ne aktivitetin 1

#### ***Treguesit (nëse ka)***

1. Raporti Vleresues ne 2006
2. Rritja e numrit te te kthyerave qe jane asistuar per punesim dhe trajnim profesional

#### ***Niveli i zbatimit***

1. E zbatuar
2. Jashtë objektit të projektit

#### ***Konsiderata***

Raporti është kompletuar në dhjetor 2005

#### ***Rekomandime***

-

## **MASA 4**

Marrja e masave per sigurimin e kushteve themelore te jeteses dhe nxitjen e investimeve ne zonat e prekuara nga nivele te larta te emigrimit.

### ***Aktiviteti***

1. Kryerja e nje studimi per identifikimin e zonave te prekura nga nivele te larta te emigracionit.
2. Parashikimi i masave emergjente qe duhet te merren ne zonat e identifikuara dhe perfshirja e tyre ne Strategjine per Zhvillim Social Ekonomik dhe Strategjine per Zhvillimin e Ndermarrjeve te Vogla dhe te Mesme.

### ***Kerkesa paraprake***

1. Nuk ka kerkesa paraprake
2. Perfundimi i studimit

### ***Institucioni pergjegjes***

1. MPCS, INSTAT
2. MF, ME

### ***Institucioni zbatues***

1. MPCS, Njesite e Qeverise Vendore, INSTAT.
2. MF/ME. Ministrite e linjes dhe NJQV, pergjegjese per strategjine per Zhvillim Socio Ekonomik, Strategjine per Zhvillimin e Ndermarrjeve te Vogla dhe te Mesme dhe Strategjite e Zhvillimit Rajonal dhe Lokal

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

1. 2006
2. 2007-2010

### ***Burimet njerezore***

1. Tre (3) eksperte per kryerjen e studimit
2. Burimet ekzistuese

### ***Buxheti ne total***

1. 30 000 euro
2. Per t'u identifikuar pas kryerjes se studimit

### ***Treguesit (nese ka)***

1. Studimi i perfunduar ne 2006

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. Jashtë objektit të Raportit

### ***Konsiderata***

Masa nuk është realizuar për shkak të mungesës së koordinimit midis institucioneve zbatuese dhe mungesë mbështetjeje financiare.

### ***Rekomandime***

1. MPCSShB do të duhet të marrë më fort rolin e liderit për koordinimin e punës me institucionet e tjera për realizimin e kësaj mase.
2. Po kështu, MPCSShB do të duhet të aktivizohet në kërkim fondesh, qoftë në kuadrin e buxhetit të shtetit, qoftë nëpërmjet ndihmës nga donatorët (si psh, Programi CARDS 2004).
3. MPCSShB duhet të përgatisë përshkrimin e punës për tre ekspertët që duhet të rekrutohen për realizimin e kërkimit.

## ***A.2 Kthimi i Migrantëve***

### ***A.2.1. Kthimi i shtetasve shqiptarë nga shtetet anëtare të BE-se***

#### ***MASA 5***

Zbatimi i marrëveshjeve të ripranimit.

#### ***Aktiviteti***

1. Ndarja e qarte e kopetencave midis strukturave që merren me trajtimin e migracionit të parregullt me ane të një akti normativ.
2. Krijimi i ambjenteve të pritjes në të gjitha pikat kufitare me kryesore, me ane të një akti normativ, vecanerisht në aeroportin e Rinasit.

#### ***Kerkesa paraprake***

-

#### ***Institucioni pergjegjes***

MRP

#### ***Institucioni zbatues***

MRP

#### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

1. 2006
2. Fundi i vitit 2005 e në vazhdim

#### ***Burimet njerezore***

-

#### ***Buxheti në total***

1. Nuk ka nevojë për buxhet shtesë
2. 240 000 Euro për 8 qendra në 8 pika kufitare

#### ***Treguesit (nëse ka)***

2. Numri i ambjenteve të rindertuara

#### ***Niveli i zbatimit***

1. E zbatuar
2. E zbatuar

#### ***Konsiderata***

Ministria e Brendshme dhe në mënyrë të vecantë Drejtoria e Policisë së Kufirit dhe Migracionit ishin aktivë për zbatimin e kësaj mase. Është firmosur një Urdhër i Ministrit të Brendshëm dhe Rregulloret në zbatim të tij në lidhje me kompetencat e strukturave të ndryshme që trajtojnë migracionin e parregullt. Janë ndërtuar apo rikonstruktuar me ndihmën financiare të Programit CARDS 2003 (Pre/screening - të kërkuesve të azilit e të migrantëve ilegalë) tetë qendra në pikat kryesore kufitare. Një kujdes i vecantë është treguar për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", në mënyrë të vecantë në pikat e kontrollit, si nga pikpamja infrastrukturore, ashtu dhe në formimin e personelit.

#### ***Rekomandime***

-

## **MASA 6**

Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave që ju drejtohen emigrantëve mbi kthimin vullnetar, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe te drejtat e tyre si edhe për shërbimet që ju ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore dhe nga shoqatat e emigrantëve me mbështetjen e organizatave kombëtare ose ndërkombëtare.

### ***Aktiviteti***

Botimi i pamfletëve që ofrojnë informacion për procedurat e kthimit në Shqipëri, shërbimet sociale për riintegrim që disponohen, etj.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MPCS

### ***Institucioni zbatues***

MRP, MPJ, MPCS

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

2006 e ne vazhdim

### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistuese

### ***Buxheti ne total***

30 000 Euro

### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i pamfleteve qe do te shperdahen

### ***Niveli i zbatimit***

E zbatuar

### ***Konsiderata***

Janë botuar dhe shpërndarë disa broshura, në bashkëpunim me IOM, lidhur me informacionin mbi procedurat e rikthimit dhe shërbimet sociale të disponueshme mbi riintegrimin e migrantëve.

### ***Rekomandime***

1. Duke qenë një masë zbatimi i së cilës do të zgjasë në kohë, MPCSShB do të duhet të parashikojë cdo vit fondet buxhetore të nevojshme.

## **MASA 7**

Pritja e te miturve te pashoqeruar te kthyer (qe nuk bejne pjese ne kategorine e viktimave te trafikuar) ne pikat kufitare.

### ***Aktiviteti***

Krijimi i mekanizmave të duhur për referim në pikat e hyrjes dhe sigurimi i ambienteve te nevojshme te pritjes.

### ***Kerkesa paraprake***

Trainimi i personelit qe merret me keto sherbime

### ***Institucioni pergjegjes***

MRP

### ***Institucioni zbatues***

MRP

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

2005

### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti ekzistues

### ***Treguesit (nëse ka)***

Nuk ka ndonje tregues

### ***Niveli i zbatimit***

E zbatuar

### ***Konsiderata***

Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit, nën varësinë e Ministrisë së Brendshme ka bërë të mundur zbatimin e kësaj mase. Fondet e nevojshme u vunë në dispozicion në kuadrin e Projektit Pre/Screening - të kërkuesve të azilit e të migrantëve ilegalë, të programit CARDS 2003. Me këtë rast është ofruar edhe formim për stafin përkatës.

### ***Rekomandime***

1. Ministria e Brendshme do të duhet të sigurojë që mekanizmat përkatës në pikat e kufirit të vazhdojnë të funksionojnë dhe të mirëmbahen ambientet edhe me tej realizimit të projektit. Për këtë qëllim, Ministria e Brendshme do të duhet të parashikojë në buxhetin e cdo viti, fondet e nevojshme.

## **MASA 8**

Zgjerimi i shërbimeve riintegruese ne menyre qe te garantohet kthimi i perhershem.

### **Aktiviteti**

- 1.Hartimi dhe zbatimi i programeve të përbashkëta te punësimit me bizneset private.
- 2.Ofrimi i shërbimit te keshillimit per karrieren, hyrjen ne pune dhe formimit profesional.

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni pergjegjes**

MPCS

### **Institucioni zbatues**

Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me Dhomën e Tregëtisë Shqiptare dhe me Agjensite e Zhvillimit Rural

### **Afati (kohezgjatja, finalizimi)**

2006 ne vazhdim

### **Burimet njerezore**

Burimet ekzistuese

### **Buxheti ne total**

Te merret parasysh studimi qe eshte parashikuar te kryhet ne masen 3

### **Treguesit (nëse ka)**

Numri i personave te asistuar me shërbime riintegruese

### **Niveli i zbatimit**

1. E pazbatuar
2. Pjesërisht e zbatuar

### **Konsiderata**

1. Janë vendosur kontakte vetëm me Dhomat e Tregëtisë.
2. Për sa i përket aktivitetit të dytë ekzistojnë disa programe të përgjithshme në Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

### **Rekomandime**

1. MPCSShB duhet të ndërmarrë nismën për krijimin e një grupi pune të përbashkët në nivel teknik të përbërë nga përfaqësues të kësaj ministrie, ShKP-së, Dhomës së Tregëtisë, Agjencisë së Zhvillimit Rural për të përgatitur orientimet kryesore për programe të përbashkëta punësimi me ndërmarrjet e vogla.
2. Të gjitha institucionet në fjalë duhet të përfshijnë këto aktivitete në programet respektive vjetore për 2007.
3. Fondet e nevojshme ose një pjesë e tyre duhet të parashikohen në buxhetet e institucioneve të përfshira.
4. Grupi i përbashkët i punës duhet të përcaktojë programe specifike te keshillimit per karrieren, hyrjen ne pune dhe formimit profesional.

## **MASA 9**

Ngritja e kapaciteteve te Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrave të saj, lokale dhe rajonale.

### ***Aktiviteti***

Programe specifike per trajnimin lidhur me asistencen per te kthyerit.

### ***Kerkesa paraprake***

Reference masa 40

### ***Institucioni pergjegjes***

MPCS

### ***Institucioni zbatues***

SHKP

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

2006

### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistues

### ***Buxheti ne total***

14 000 Euro per 5 vjet (15 persona te trainuar gjate 5 ditesh ne vitin e pare dhe dy dite cdo vit qe ne vitin e dyte)

### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i personave te trainuar

### ***Niveli i zbatimit***

E zbatuar

### ***Konsiderata***

Po zbatohen programe formimi specifik në tre zyra rajonale punësimi me mbështetjen e IOM.

### ***Rekomandime***

-

## ***A.2.2. Kthimi i shtetasve të vendeve të treta në Shqipëri nga shtetet anetare te BE***

### ***MASA 10***

Zbatimi i marrëveshjeve të ripranimit duke përfshirë Shqipëri/ BE dhe ato në lidhje me shtetasit e vendeve të treta.

### ***Aktiviteti***

Planifikimi, rehabilitimi/ndërtimi dhe funksionimi i ambjenteve për mbajtjen e shtetasve të vendeve të treta në pritje të kthimit nepermjet :

- a) Kryerjes se nje studimi fizibiliteti ;
- b) Rehabilitimi dhe ndertimi i ambjenteve.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MRP

### ***Institucioni zbatues***

MRP

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

- a.Mesi i 2006
- b.2007

### ***Burimet njerezore***

-

### ***Buxheti ne total***

- b) 1. 320. 000 Euro (330 000 euro ne vit per 4 vjet)

### ***Treguesit (nëse ka)***

Nuk ka ndonje tregues

### ***Niveli i zbatimit***

E zbatuar

### ***Konsiderata***

Studimi i fizibilitetit është realizuar me mbështetjen e IOM. Është bërë i mundur kalimi i pronësise se lokaleve që duhen ristrukturuar për mbajtjen e shtetasve të vendeve të treta, nga Ministria e Mbrojtjes në Ministrinë e Brendshme.

### ***Rekomandime***

1. Ministria e Brendshme duhet të emërojë dhe formojë personelin e nevojshëm, në të njëjtën kohë me rehabilitimin e ambjenteve, në mënyrë që të mos vonohet funksionimi i qendrës.

### ***A.2.3 Kthimi i shtetasve të vendeve të treta nga Shqipëria për në vendet e tyre.***

#### ***MASA 11***

Sigurimi i informacionit te nevojshem dhe informimi i te kthyerve mbi mundësitë e kthimit vullnetar në atdhe.

#### ***Aktiviteti***

1. Caktimi i personave pergjegjes per dhenien e informacionit dhe ndihmes se nevojshme ne pikat kufitare
2. Hartimi dhe shperndarja e posterave dhe pamfletëve informativë per kthimin vullnetar, avantazhet e tij, te drejtat e migranteve

#### ***Kerkesa paraprake***

-

#### ***Institucioni pergjegjes***

MRP

#### ***Institucioni zbatues***

MPJ

#### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

2006 e ne vazhdim

#### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistuese

#### ***Buxheti ne total***

Per t'u llogaritur ne perputhje me rezultatet e funksionimit te Marreveshjes se Ripranimit

#### ***Treguesit (nëse ka)***

Nuk ka ndonje tregues

#### ***Niveli i zbatimit***

E zbatuar

#### ***Konsiderata***

1. Janë emëruar personat përgjegjës.
2. Me ndihmën e Komitetit të Helsinkit, kartela me përmbajtje të drejtat e migrantëve, në shqip dhe anglisht janë vendosur në të gjitha pikat e kufirit. Nga ana tjetër, këto të drejta mund të konsultohen në faqen e internetit te Ministrisë së Brendshme.

#### ***Rekomandime***

-

## **MASA 12**

Permiresimi i procedurave te rikthimit ne vendin e origjines permes lehtesimit te sigurimit te dokumentacionit te nevojshem.

### **Aktiviteti**

1. Kontaktimi dhe informimi i ambasadave në Shqipëri.
2. Kontaktimi i ministrive përkatëse në vendet e treta duke shfrytëzuar ambasadat shqiptare jashtë vendit.

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni pergjegjes**

MPJ

### **Institucioni zbatues**

1.MPJ

2.MPJ/MRP

### **Afati (kohezgjatja, finalizimi)**

2006

### **Burimet njerezore**

Burimet ekzistuese

### **Buxheti ne total**

Buxheti ekzistues

### **Treguesit (nëse ka)**

Nuk ka ndonje tregues

### **Niveli i zbatimit**

1. E zbatuar
2. E zbatuar

### **Konsiderata**

2. Aktualisht është në fuqi një Udhëzim i Ministrit të Punëve të Jashtme për lëshimin e leje-kalimit për të rikthyerit vullnetarë. Ambasadat Shqiptare janë kontaktuar nga MPJ në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me këtë masë.

### **Rekomandime**

-

### **MASA 13**

Negocimi dhe nenshkrimi i marrëveshjeve të ripranimit me vendet e treta dhe të kërkohej asistencë e KE për këtë.

#### **Aktiviteti**

1. Identifikimi i vendeve të origjinës dhe vendeve tranzit me të cilët duhet të nënshkruhen marrëveshjet e pranimit.
2. Mbatja e takimeve përgatitore me përfaqësues nga vendet e origjinës dhe vendeve tranzit, hartimi dhe nenshkrimi i marrëveshjeve të ripranimit.

#### **Kërkesa paraprake**

-

#### **Institucioni përgjegjës**

MRP, MEI, MPJ

#### **Institucioni zbatues**

MRP, MEI, MPJ

#### **Afati (kohezgjatja, finalizimi)**

2005-2010

#### **Burimet njerezore**

Burimet ekzistuese

#### **Buxheti në total**

Buxheti ekzistues

#### **Treguesit (nëse ka)**

Nuk ka ndonjë tregues

#### **Niveli i zbatimit**

1. E zbatuar
2. E zbatuar

#### **Konsiderata**

1. Është përgatitur nga MPJ një listë prioritetesh ;

2. Janë realizuar takime përgatitore me vende të tjerë, me vende të rajonit por edhe më gjerë. Norvegjia, Kroacia dhe Maqedonia janë nga vendet prioritare. Ekziston vullneti për të firmosur marrëveshje me Indinë dhe Kinën, por me këtë të fundit ekzistojnë probleme politike. Megjithatë, marrëveshje të tjera ripranimi nuk konsiderohen për momentin si prioritete.

Pavarësisht nga këto, është pranuar dhe njohur një mungesë koordinimi midis institucioneve. Ministria e Brendshme ka deklaruar se nuk ka asnjë përgjegjës në lidhje me zbatimin e kësaj mase.

#### **Rekomandime**

1. Duhet organizuar një takim midis organizmave përgjegjës për të qartësuar rolin e gjithsecilit në përgatitjen dhe firmosjen e marrëveshjeve të ripranimit.

## ***B. Emigracioni dhe zhvillimi i Shqipërisë***

### ***B.1.1. Perfitimet nga Shqiptaret qe jetojne jashte vendit***

#### ***B.1.1.1. Përmirësimi i imazhit të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit***

### ***MASA 14***

Krijimi i Instituteve Kulturore Shqiptare në Greqi dhe Itali, për të promovuar imazhin e Shqipërisë dhe emigrantëve shqiptarë si edhe për të ofruar disa shërbime për komunitetin e emigrantëve shqiptarë.

#### ***Aktiviteti***

1. Miratimi i VKM "Per ngritjen e Instituteve te Kultures ne vendet pritese ku gjendet nje komunitet i madh Shqiptar".
2. Promovimi i ketyre Instituteve nepermjet fushatave mediatike ne Shqiperi dhe ne vendet pritese.

#### ***Kerkesa paraprake***

-

#### ***Institucioni pergjegjes***

MKRS, MPJ

#### ***Institucioni zbatues***

MKRS, MPJ

#### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

1. 2006
2. 2007

#### ***Burimet njerezore***

6 persona te punesuar ne cdo institut

#### ***Buxheti ne total***

1. 200 000 Euro per vit (per te secilin nga Institutet) total per 5 vjet =1.6 milion euro
2. Buxheti ekzistues i MKRS-e

#### ***Treguesit (nëse ka)***

Aktivitetet e organizuara dhe shërbimet e ofruara per emigrantet nga Institutet te raportohen cdo vit

#### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. Jashtë objektit të projektit

### ***Konsiderata***

Nuk është aprovuar vendimi dhe parashikohet te behet gjate 2007-s. IKD po punon në këtë drejtim, por deri tani asnjë Institut Kulturor nuk është krijuar për shkak të mungesës së fondeve.

### ***Rekomandime***

1. MPJ duhet të përshpejtojë procedurat për aprovimin e vendimit të përmendur më sipër.
2. Fondet e nevojshme për punësimin e stafit të ri (12 persona) dhe funksionimi i dy instituteve duhet të parashikohen në buxhetin e shtetit.
3. Përshkrimi i punës i stafit të ri duhet të përcaktohet nga IKD në bashkëpunim me MTKRS dhe DAP.

## **MASA 15**

Perfshirja e komunitetit te emigranteve shqiptare ne jeten kulturore te vendit prites dhe ne Shqiperi me qellim promovimin e tyre.

### ***Aktiviteti***

1. Nenshkrimi dhe/ose amendimi i marreveshjeve dypaleshe duke perfshire elementin migrator ne to.
2. Evidentimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, shkencore qe veprojne ne vendet prites si dhe evidentimi i individeve te talentuar dhe te suksesshem qe veprojne ne keto fusha (bazuar dhe ne listen e Institutit te Diapsores).

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MKRS

### ***Institucioni zbatues***

MKRS, MPJ

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

2006 dhe ne vazhdimesi

### ***Burimet njerezore***

Burimet njerezore egzistuese

### ***Buxheti ne total***

Brenda buxhetit ekzistues te MKRS-se

### ***Treguesit (nëse ka)***

1. Numri i ketyre marreveshjeve te nenshkruara dhe te rishikuara
2. Numri i shoqatave dhe individeve te identifikuar dhe te perfshirë ne banken e te dhenave

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

MTKRS nuk njihte ekzistencën e PKVM. Kjo Ministri nuk e ka përfshirë masën në fjalë në programin e saj vjetor, megjithëse e konsideron migracionin si një çështje prioritare. Nuk është vendosur një kontakt i rregullt midis MTKRS dhe IKD, asnjë marrëveshje bilaterale me vendet pritës e nënshkruar së fundi dhe nuk ekziston një bazë të dhënash apo listë, detyrë kjo e IKD.

### **Rekomandime**

1. KNM në takimin e radhës duhet të vërë theksin tek domosdoshmëria e zbatimit të Strategjisë dhe PKVM.
2. Duhet të vendosen kontakte të rregullta midis IKD dhe MTKRS.

3. IKD duhet të përshpejtojë procedurat për bërjen të disponueshme të një baze të dhënash complete me informacione për shoqatat kulturore, sportive, edukative, shkencore që zhvillojnë aktivitet në vendet pritëse dhe mbi individë të talentuar dhe të suksesshëm në këto fusha.

## **MASA 16**

Promovimi i rasteve te personaliteteve te sukseshme ne vendet pritese dhe ne Shqiperi.

### ***Aktiviteti***

- 1.Dhenia e titullit “Ambasador i Kombit” ketyre personaliteve nga autoritet shqiptare.
- 2.Promovimi ketyre personaliteteve ne bashkepunim me TVSH (realizimi i nje programi te ri televiziv te titulluar “100 shqiptaret e mirenjohur” ne fund te 2005 ose 2006).

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MKRS, MASH, TVSH

### ***Institucioni zbatues***

MKRS, MASH

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

2006-ne vijim

### ***Burimet njerezore***

Me burimet njerezore ekzistuese ne te tre institucionet

### ***Buxheti ne total***

1. Buxhetit ekzistues
2. Kosto totale e dokumentarit 45 .000 euro

### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i titujve qe do te jepen ne vit

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Deri tani nuk është dhënë asnjë titull “Ambasador i Kombit” nga autoritetet shqiptare sipas MASH. MASH dhe MTKRS nuk ishin në dijeni të masave specifike të përfshira në PKVM.

Edhe pse parashikuar për fundin e 2005 ose 2006, TVSH ndodhet akoma në fazën përgatitore të organizimit të këtij programi dhe nuk ka nisur akoma bashkpunimin me MTKRS, e cila, sipas përfaqësuesve të TVSH do të fillojë me mbylljen e fazës përgatitore.

## Rekomandime

1. KNM në takimin e rradhës duhet të vërë theksin tek domosdoshmëria e zbatimit të Strategjisë dhe PKVM.
2. Një grup pune i përbashkët duhet krijuar midis MASH dhe MTKRS për zbatimin e kësaj mase.
3. Duhet të parashikohen fondet e nevojshme në buxhetin e Shtetit apo nga donatorët për zbatimin e kësaj mase (një kërkim fondesh mund të jetë i nevojshëm).
4. TVSH duhet të përshpejtojë ritmet e organizimit të programit, duke filluar, pa humour, kohë bashkpunimin me MTKRS dhe MASH.

## **MASA 17**

Organizimi i nje fushate mediatike ne Itali dhe Greqi lidhur me promovimin dhe informimin e :

1. Migrimit si fenomen ;
2. Identitetit te shqiptareve, historisë dhe kulturës shqiptare ;
3. Rreth zhvillimeve me te fundit politike, sociale dhe ekonomike ne vend si dhe te përpjekjeve të bëra ne kuader te procesit te integritit te Shqiperise ne Bashkimin Evropian.

### ***Aktiviteti***

1. Hartimi dhe nenshkrimi i Marreveshjes mes TVSH dhe kanaleve televizive kombetare te vendeve pritese per transmetimin kesaj fushte mediatike.
2. Realizimi i nje dokumentari nga TVSH mbi fenomenin e emigracionit shqiptar. Ky dokumentar duhet të jetë i përkthyer në greqisht, italisht dhe anglisht.
3. Realizimi i disa minidokumentareve dhe fushatave mediatike promovuese mbi historine e lashte dhe kulturen e shqiptareve.

### ***Kerkesa paraprake***

Nenshkrimi i Marreveshjes se Bashkepunimit mes MPCS, MASH, MKRS dhe TVSH dhe gjithashtu me televizionet kombetare te vendeve pritese.

### ***Institucioni pergjegjes***

TVSH, MKRS, MPCS

### ***Institucioni zbatues***

TVSH, MKRS, MPCS

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

2006-2008

### ***Burimet njerezore***

Burimet njerezore ekzistuese ne keto institucione

### ***Buxheti ne total***

55.000 Euro

### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i transmetimeve te dokumentareve dhe audienca e tyre

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. Pjesërisht e zbatuar
3. Pjesërisht e zbatuar

### ***Konsiderata***

Marrëveshja e bashkëpunimit midis MPCSShB, MTKRS, TVSh dhe televizionet kombëtare të vendeve të tjera nuk është nënshkruar. Për pasojë, vetëm disa filma me subjekte të parashikuara nga masa në fjalë, janë transmetuar nga TVSh edhe pse jo të realizuar nga bashkëpunimi midis këtyre organizmave. Ka munguar koordinimi. MTKRS nuk ishte në dijeni të masës në fjalë. Asnjë nga ministrinë e cituara nuk i ka përfshirë këto aktivitete në programet e saj vjetore.

### ***Rekomandime***

1. RTVSh duhet të ndërmarrë iniciativën e organizimit të një komiteti të përbashkët me organizmat e tjerë përgjegjës për identifikimin e temave që duhen përfshirë në dokumentarët dhe për konceptimin e përbashkët të tyre.
2. RTVSh duhet të luajë rolin e liderit në përshejtimin e procedurave për nënshkrimin e marrëveshjeve të parashikuara të bashkëpunimit.
3. Ambasadat Greke, Italiane dhe Angleze duhet të përfshihen, si për të lehtësuar nënshkrimin e marrëveshjeve, ashtu edhe për bashkëfinancim të mundshëm.

## ***B. Emigracioni dhe zhvillimi i Shqipërisë***

### ***B.1.1.2. Përmirësimi i shërbimeve konsullore dhe diplomatike shqiptare per shqiptaret ne vendet pritese.***

#### ***MASA 18***

Ngritja e kapaciteteve dhe caktimi i personelit te nevojshem per ofrimin e shërbimeve konsullore dhe asistencen ne çështjet migratore dhe ligjore per emigrantet.

#### ***Aktiviteti***

1. Identifikimi i mangesive dhe nevojave per personel te specializuar ne ofrimin e shërbimeve konsullore dhe asistences se specializuar ne fushen migratore dhe ligjore per emigrantet ne MPJ/Ambasadat dhe Konsullatat.
2. Caktimi i personelit te nevojshem.

#### ***Kerkesa paraprake***

2. Perfundimi i raportit vleresues per identifikimin e mangesive dhe nevojave

#### ***Institucioni pergjegjes***

MPJ

#### ***Institucioni zbatues***

MPJ

#### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

1. 2005
2. 2006 dhe ne vijim ne baze te nevojave te indentifikuara

#### ***Burimet njerezore***

1. Burimet ekzistuese
2. Per t'u identifikuar ne baze raportit ne piken 1

#### ***Buxheti ne total***

1. Buxheti ekzistues
2. Per t'u identifikuar ne baze te raportit ne piken 1

#### ***Treguesit (nëse ka)***

1. Raporti vleresues mbi mangesite dhe nevojat
2. Shtimi i numrit te personelit te specializuar.

#### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar

#### ***Konsiderata***

1. Raporti i vlerësimit për identifikimin e mungesave dhe nevojave nuk është realizuar. Nga informacionet e mbledhura, mësohet se shërbimet konsullore në vendet e treta janë

të nivelit të mesëm, ndërsa është e disponueshme një asistencë ligjore fare e vogël për migrantët. Përveç kësaj, mungon një bazë të dhënash të përgjithshme të gjendjes civile e planifikuar për 2014.

2. Mungesa e fondeve është arsyeja kryesore e mungesës së rekrutimit të stafit të nevojshëm.

### ***Rekomandime***

1. MPJ duhet të kompletojë mbledhjen e të dhënave për finalizimin e raportit të vlerësimit të sipërpërmendur.
2. Ndihma ligjore/migratore duhet të parashikohet si një prej shërbimeve të kualifikuar që konsullatat duhet të ofrojnë.
3. Fondet e nevojshme duhet të parashikohen për punësimin e stafit të specializuar.
4. Përshkrimi i punës për stafin e specializuar duhet të përcaktohet në bashkëpunim me DAP.

## **MASA 19**

Hartimi dhe botimi nga MPJ, në bazë të informacioneve tremujore të marra nga përfaqësitë, të një raportit vjetor mbi asistencën e dhënë ndaj qytetarëve shqiptarë dhe mbi gjendjen konkrete të komunitetit shqiptar jashtë shtetit, në menyre të vecante në Itali dhe Greqi.

### **Aktiviteti**

1. Vlerësimi i asistencës që ofrohet nga përfaqësitë tona jashtë shtetit dhe identifikimi i nevojave, sidomos në fushën e mbrojtjes/asistencës ligjore që u ofrohet emigrantëve në bote.

2. Hartimi dhe botimi i raportit në bazë të informacioneve të marra nga përfaqësitë jashtë vendit.

### **Kerkesa paraprake**

Percaktimi dhe miratimi i metodologjisë së punës dhe strukturës së raportit nga MPJ

### **Institucioni përgjegjës**

MPJ

### **Institucioni zbatues**

MPJ

### **Afati (kohezgjatja, finalizimi)**

1. 2006 dhe në vazhdim në periudha tremujore
2. 2006 dhe në vazhdim çdo vit

### **Burimet njerezore**

Caktimi i një specialisti për mbledhjen dhe vlerësimin e materialit

### **Buxheti në total**

6000 euro për specialistin dhe 5000 euro për botimin dhe shpërndarjen e raportit (çdo vit - 11 000 euro - 55 mijë euro në pesë vjet)

### **Treguesit (nëse ka)**

1. Raportet tre mujore nga përfaqësitë tona
2. Raportet vjetore

### **Niveli i zbatimit**

1. Pjesërisht e zbatuar
2. E pazbatuar

### **Konsiderata**

1. Një vlerësim i pjesshëm i ndihmës ligjore/migratore që u jepet emigrantëve në konsullatat jashtë është bërë. Megjithatë, asnjë specialist nuk është punësuar për mbledhjen dhe vlerësimin e materialit.

2. Informacionet e mbledhura nëpërmjet raporteve vjetore të konsullatave janë akoma të paplotë.

### **Rekomandime**

1. MPJ duhet tu kërkojë të gjitha konsullatave në vendet pritëse informacionet e munguara.
2. Profili i specialistit për vlerësimin e materialit duhet të përcaktohet në bashkëpunim me DAP.
3. Buxheti i nevojshëm për punësimin e specialistit duhet të parashikohet ose, në rast pamundesie, duhet të ngarkohet me këtë detyrë një specialist i seleksionuar brenda ministrisë.

## **MASA 20**

Trajnimi i diplomatëve lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e emigranteve.

### **Aktiviteti**

Organizimi i seminareve të posaçme në fushën e migracionit dhe shërbimeve konsullore nga MPJ/AD për trajnimin e diplomatëve.

### **Kerkesa paraprake**

Identifikimi i nevojave për trajnime dhe përgatitja e moduleve të posaçme trajnuese në këtë fushë.

### **Institucioni përgjegjës**

MPJ

### **Institucioni zbatues**

MPJ, MPC

### **Afati (kohezgjatja, finalizimi)**

2006-2010 Trajnime periodike në bazë të nevojave

### **Burimet njerezore**

Burimet ekzistuese

### **Buxheti në total**

60000 euro

### **Treguesit (nëse ka)**

Numri i trajnimeve të organizuara dhe numri i diplomatëve të trajnuar

### **Niveli i zbatimit**

E pazbatuar

### **Konsiderata**

MPJ ka planifikuar seksione formuese për çështjen migratore për 2007. Takimet e realizuara nga IET në kuadrin e këtij projekti i kanë krijuar mundësinë MPJ të vendosë kontakte me ITAP. Një bashkëpunim midis ITAP dhe Akademisë Diplomatike do të fillojë për pasojë për sesionet e formimit të sipërpërmendur.

### **Rekomandime**

1. Një grup i përbashkët pune midis MPJ dhe MPCSShB do të duhet të identifikojë nevojat për formim në fushën migratore për diplomatët :
2. Në bazë të nevojave për formim të identifikuar, ITAP, në bashkëpunim me Akademinë Diplomatike, do të duhet të punësojë një ekspert për redaktimin e kurrikulave specifike për diplomatët.
3. Fondet e nevojshme për realizimin e sesioneve të formimit duhet të parashikohen në buxhetin e MPJ.

## **MASA 21**

Hapja e faqeve elektronike të ambasadave dhe vënia në dispozicion në këto faqe të informacioneve për shërbimet që u ofrohen emigrantëve (me prioritet Greqia dhe Italia).

### **Aktiviteti**

1. Paisja me faqe elektronike të të gjitha përfaqësive.
2. Hartimi i katalogut të shërbimeve konsullore për emigrantët dhe vendosja e tij ne faqen e internetit.

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni pergjegjes**

MPJ

### **Institucioni zbatues**

MPJ/MPCS

### **Afati (kohezgjatja, finalizimi)**

2006

### **Burimet njerezore**

Nje specialist ne MPJ

### **Buxheti ne total**

Afro 5 mijë euro ne vit per postin e specialistit

10 000 euro per faqet e internetit ne perfaqesite tona diplomatike (35.000 euro ne pese vjet)

### **Treguesit (nëse ka)**

Numri i vizitoreve ne faqet perkatese te internetit

### **Niveli i zbatimit**

1. Pjesërisht e zbatuar
2. E zbatuar

### **Konsiderata**

1. Ka dalë urdhëri i Ministrit të Punëve të Jashtme për krijimin e faqeve ne internet në ambasada të ndryshme. Vetëm disa nga ambasadat e kanë një të tillë.
2. Një katalog me shërbimet konsullore për emigrantët ekziston dhe është i disponueshëm në faqen internet, qendrore të MPJ.

### **Rekomandime**

1. Punësimi i specialistit për krijimin e faqes se internetit, duhet të parashikohet në buxhetin e 2007.
2. Specialisti duhet të dërgohet me mision në ambasada të ndryshme për supervizionin e krijimit të faqes ne internet dhe për të përfshirë katalogun e shërbimeve konsullore në to.
3. Një pikë kontakti për faqen ne internet duhet të përcaktohet në të gjithë ambasadat për të bashkëpunuar me specialistin.
4. Një plan për azhornimin e vazhdueshëm të faqeve ne internet, do të duhet te planifikohet nga specialisti dhe te zbatohet nga pikat e kontaktit nën supervizimin e tij.

## ***B. Emigracioni dhe zhvillimi i Shqipërisë***

### ***B.1.1.3. Mbrojtja e të drejtave të emigrantëve shqiptarë***

#### ***MASA 22***

Krijimi i komisioneve konsultative te nivelit te larte, vecanerisht me Italine dhe Greqine, mes ministrive që mbulojnë çështjet migratore, bazuar ne strukturat ekzistuese ose ne krijimin e nje strukture te re.

#### ***Aktiviteti***

1. Negocimi dhe nenshkrimi i nje marreveshjeje mirekuptimi ndermjet institucioneve tona me institucionet homologe ne Itali dhe Greqi.
2. Ngritja dhe funksionimi i ketyre komisioneve ne menyre periodike.

#### ***Kerkesa paraprake***

Marreveshje me Greqine dhe Italine

#### ***Institucioni pergjegjes***

MPJ, MPÇS

#### ***Institucioni zbatues***

MPJ, MPÇS, MRP, ISSH

#### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

Vendosja e kontakteve, 2005

#### ***Burimet njerezore***

Burimet njerezore ekzistuese

#### ***Buxheti ne total***

Buxheti ekzistues

#### ***Treguesit (nëse ka)***

Fillimi veprimtarisë së komisioneve : 2006 e në vijim ne qofte se eshte rene dakort me vendet perkatese

#### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar

#### ***Konsiderata***

Në kuadrin e aktiviteteve të parashikuara për këtë masë, janë realizuar vetëm kontaktet e para gjatë vizitave zyrtare në Greqi nga ana e Kryeministrit dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Nuk ka patur zhvillime të mëtejshme dhe mbetemi në nivelin e marrëveshjeve në parim. Koordinimi midis organizmave për

zbatimin e kësaj çështjeje ka munguar plotësisht. Vetëm MPCSShB ka parashikuar realizimin e këtyre aktiviteteve në Programin Vjetor 2006-2007.

***Rekomandime***

1. MPJ duhet të luajë rolin e liderit për të organizuar takime të nivelit të lartë midis përfaqësuesve të organizmave të zbatimit dhe autoriteteve analoge në Greqi dhe Itali.
2. Teksti i dy memorandumeve të mirëkuptimit duhet të redaktohet bashkërisht nga Komisionet Konsultative (greko/shqiptare dhe italiano/shqiptare) dhe procedurat ligjore për nënshkrimin duhet të fillojnë.

## **MASA 23**

Informimi i shoqatave te emigranteve shqiptare ne Greqi dhe Itali mbi rrugët e ndryshme per te apeluar ndaj shkeljeve te te drejtave te emigrantëve ne strukturat perkatese te ketyre vendeve si dhe në ato nderkombetare.

### ***Aktiviteti***

Kryerja e nje fushate sensibilizimi lidhur me mundesite e ndryshme per te apeluar ndaj shkeljeve te te drejtave te emigranteve ne strukturat perkatese te ketyre vendeve si dhe ne ato nderkombetare, te cilat merren me mbrotjen dhe respektimin e te Drejtave te Njeriut si dhe mbrotjen e te drejtave te migranteve nepermjet aktiviteteve si:

1. Publikimi i ketyre informacioneve ne faqen e internetit per migracionin ëëë.migrantinfo.gov.al
2. Botimi ne gazetate shqiptare jashte vendit.
3. Botimi dhe shperndarja e fletepalosjeve lidhur me keto informacione.
4. Publikimi i ketyre te drejteve nepermjet faqeve te internetit te krijuara nga komuniteti shqiptar qe vepron jashte vendit.

Disa nga strukturat nderkombetare qe merren me keto te drejta jane si me poshte:

- o Special rapporteur for migrant's rights of the United Nations - Reporteri Special per te Drejtat e Migranteve.
- o Commissioner for Human rights of the Council of Europe - Komisioneri per Mbrotjen e te Drejtave te Njeriut ne Keshillin e Evropes.
- o European Court in Human rights - Gjykata Evropiane per Mbrotjen e te Drejtave te Njeriut.
- o European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) of the Council of Europe. Komisioni Evropian kunder Racismit dhe Intolerances dhe vendet anetare te tij ne Greqi dhe Itali ne Keshillin e Evropes.
- o Commission for Petition of European Parliament for the EU. Komisioni i Peticioneve te Parlamentit Evropian.
- o Ombudsman of the EU - Avokati i Popullit i BE-se.

### ***Kerkesa paraprake***

Kryerja e studimeve ne keto vende për të drejtat e emigrantëve, duke patur parasysh edhe shkeljet më frekvente të tyre.

### ***Institucioni pergjegjes***

MPJ, Avokati i Popullit

### ***Institucioni zbatues***

MPJ, MPCS Avokati i Populli

### ***Afati (kohezgjatja, finalizimi)***

2006 e ne vazhdim

### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistuese

### ***Buxheti ne total***

Buxheti per realizimin e kesaj fushate sensibilizimi :

- 6000 euro per botimin ne gazeta
- 7000 euro per botimin dhe shperndarjen e fletepalosjeve

Studimet :

- 2500 Euro per kryerjen e studimit ne Itali
- 2500 Euro per kryerjen e studimit ne Greqi

### ***Treguesit (nëse ka)***

1. Botimet e ndyshme qe do te behen lidhur me mbrotjen e te drejtave te emigranteve
2. Studimet ne Itali dhe Greqi lidhur me shkeljet e ketyre te drejtave

### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Masa nuk është realizuar sipas parashikimit as nga MPJ as nga AP për shkak të mungesës së fondeve. Megjithatë, shërbimi konsullor në vendet pritëse realizon cdo ditë detyrën e dhënies së informacioneve për të drejtat e tyre edhe pse ndihma ligjore e ofruar është mjaft e “varfër”. Nga ana tjetër, janë vendosur kontakte midis ombudsmanit shqiptar dhe atij grek dhe një numër fletë-palosjesh i janë dhënë ombudsman grek dhe ambasadës shqiptare, me qëllimin për të informuar emigrantët shqiptar në Greqi për mundësitë për rekurse kundër dhunimeve të të drejtave të tyre. Po kështu, edhe faqja e internetit e Avokatit të Popullit përmban informacione të tilla. Sipas perfaqesuesit të Avokatit të Popullit, ky institucion nuk është i mireinformuar në lidhje me përgjegjësitë e tij në kuadrin e zbatimit të SKM dhe PKVM. Pa dyshim, një fushatë sensibilizimi global mbi temën e sipërpërmendur nuk është realizuar. Nuk janë realizuar as publikime e as studime specifike. Reduktimi i përgjithshëm i buxhetit të shtetit për organizmat e zbatimit ka luajtur një rol negativ në kapacitetin zbatues të tyre, në mënyrë të vecantë, zyrën e Avokatit të Popullit. Në fakt, në 2006-n, ky institucion bëri të mundur vetëm aktivitete rutin. Nga ana tjetër, janë konstatuar probleme teknike në përdorimin e faqes se internetit [www.migrant.info.gov.al](http://www.migrant.info.gov.al) dhe aktualisht duket e vështirë azhurnimi i saj nga ana e organizmave kompetent.

### ***Rekomandime***

1. Organizmi përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin global të Strategjisë dhe Planit të Veprimit do të duhej të organizonte një takim me Avokatin e Popullit me qëllim familjarizimin e stafit të tij me dokumentat e të dyja palëve.
2. MPCSShB duhet të zgjidhë problemet teknike të funksionimit të faqes se internetit ose nëpërmjet një specialisti IT të brendshëm ose duke punësuar një të jashtëm për këtë qëllim.
3. Një grup i përbashkët pune, i përbërë nga specialistë të MPCSShB, MPJ dhe Avokatit të Popullit duhet të krijohet për përcaktimin e fushatës së sensibilizimit.
4. Buxheti i nevojshëm duhet të parashikohet në institucione të ndryshme për të dy studimet dhe për fushatën sensibilizuese.

## **MASA 24**

Vendosja e kontakteve me Grupin Evropian te Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të hetuar mbi mundësitë e mbështetjes së politikës për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë ne vendet pritese te BE-se.

### **Aktiviteti**

Vendosja e kontakteve dhe bashkepunimit me autoritet lokale/rajonale ne Greqi dhe Itali anetare te ERLAI –it.

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni pergjegjes**

MPJ, MPÇS

### **Institucioni Zbatues**

MPJ

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

Gjashtëmuji i parë 2006

### **Burimet njerezore**

Burimet njerezore ekzistuese

### **Buxheti ne Total**

Buxheti eshte llogaritur per kryerjen e 3 vizitave zyrtare ne Bruksel, Greqi dhe Itali.  
Gjithsej 7500 euros

### **Treguesit (nëse ka)**

Bashkepunimi dhe numri i kontakteve me autoritet lokale/rajonale ne Greqi dhe Itali anetare te ERLAI –t.

### **Niveli i zbatimit**

E pazbatuar

### **Konsiderata**

Është bërë shumë pak për realizimin e kësaj mase. Një kontakt i parë me ERLAI-n është realizuar në qershor të vitit 2005, por gjithcka ka mbetur në vend dhe nuk ka patur zhvillime të mëtejshme. Pa dyshim, vendosja e këtyre kontakteve mund të bëjë të mundur një politikbërje më profesionale për autoritetet shqiptare, sikurse një ndërhyrje më eficiente në rastet e dhunimit të të drejtave të emigrantëve jashtë.

### **Rekomandime**

1. Ambasadat Shqiptare në Greqi dhe Itali duhet të mbledhin informacionin e nevojshëm për të zhvilluar më tej kontaktet me anëtarët e ERLAI-t në nivel lokal.
2. MPJ duhet të përfshijë tre misionet e parashikuara në këtë masë në programin e punës për 2007 dhe të ndërmarë hapat e nevojshëm për të organizuar këto takime.

## **MASA 25**

Vendosja dhe intensifikimi i kontakteve të ngushta ndërmjet shoqatave të emigrantëve shqiptarë dhe shoqatave greke dhe italiane për mbrojtjen e imigrantëve;

### **Aktiviteti**

1. Identifikimi i organizatave greke dhe italiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende.
2. Vendosja e kontakteve me këto organizata dhe organizimi i takimeve vjetore.

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni përgjegjës**

MPJ, MPÇS,

### **Institucioni Zbatues**

MPJ, MPÇS

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

2006 e në vazhdimi

### **Burimet njerezore**

Burimet njerezore ekzistuese

### **Buxheti në Total**

1. 5000 Euro për Greqinë
2. 5000 euro për Itali

### **Treguesit (nëse ka)**

Hartimi i listës së ketyre shoqatave, së bashku me kontaktet përkatëse.

### **Niveli i zbatimit**

1. E zbatuar
2. E zbatuar

### **Konsiderata**

Organizatave Greke dhe Italiane për mbrojtjen e të drejtave të imigrantëve janë identifikuar. Një listë e tillë është e disponueshme. Kontakte të vazhdueshme me këto organizata janë vendosur.

### **Rekomandime**

-

## **MASA 26**

Venia ne levizje, nga Qeveria Shqiptare, e strukturave Nderkombetare qe merren me mbrotjen e emigranteve.

### ***Aktiviteti***

Raportimi nga ana e Qeverise Shqiptare per rastet e shkeljeve te drejtave te emigranteve shqiptare, ne strukturat nderkombetare qe merren me mbrotjen e emigranteve si psh:

- Comissioner for Human rights of the Council of Europe  
Komisioneri per Mbrotjen e te Drejtave te Njeriut ne Keshillin e Evropes.
- Special rapporteur for migrant's rights of the United Nations.  
Reporteri Special per te drejtat e Emigranteve.
- European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) of the Council of Europe.  
Komisioni Evropian kunder Racismit dhe Intolerances dhe vendet anetare te tij ne Greqi dhe Itali ne Keshillin e Evropes. etj.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MPJ

### ***Institucioni Zbatues***

MPJ

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2007 e ne vazhdim

### ***Burimet njerezore***

Burimet njerezore ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti ekzistues

### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i raportimeve ne strukturat nderkombetare perkatese.

### ***Niveli i zbatimit***

Jashtë objektit të raportit

### ***Konsiderata***

-

### ***Rekomandime***

-

## **MASA 27**

Nxitja dhe mbështetja e shoqatave e emigrantëve shqiptarë në Greqi dhe Itali për të kërkuar krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku emigrantët shqiptarë janë të përqëndruar, mbi bazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës

### **Aktiviteti**

1. Identifikimi I zonave me te populluara me emigrantet shqiptare, ne Itali dhe Greqi.
2. Ndergjegjesimi dhe realizimi i nje fushate informuese i ketyre shoqatave lidhur me nevojen e krijimit te ketyre strukturave

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni pergjegjes**

MPJ

### **Institucioni Zbatues**

MPJ, MPCS

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

2006 e ne vazhdim

### **Burimet njerezore**

Burimet njerezore ekzistuese

### **Buxheti ne Total**

10 000 euro per te dyja aktivitetet.

### **Treguesit (nëse ka)**

Bashkepunimi nderstruktural mes shoqatave te emigranteve shqiptare dhe atyre vendase.

### **Niveli i zbatimit**

1. E zbatuar
2. E pazbatuar

### **Konsiderata**

Janë identifikuar zonat më të populluar nga emigrantë Shqiptarë në Itali dhe Greqi, por asnjë veprim nuk është ndërmarrë nga MPJ për realizimin e fushatës informativo-sensibilizuese. Mungesa e fondeve ka qenë një nga arsyet e mosrealizimit të aktiviteteve.

### **Rekomandime**

1. Duhet të zgjerohen kontaktet midis MPJ (IKD) dhe shoqatave te migrantëve shqiptare në këto zona. IKD duhet tu shpërndajë atyre kopje të manualit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës të Këshillit të Evropës.
2. IKD duhet të përcaktojë përmasat e fushatës sensibilizuese dhe të parashikojë fondet e nevojshme në buxhetin e shtetit.

## **MASA 28**

Lobimi nga strukturat qeveritare me organet greke dhe Italiane pergjegjese per zbatimin e Direktives se EU lidhur me të drejtën e bashkimit familjar si dhe me statusin e shtetasve të vendeve të treta të cilët janë me qëndrim afatgjatë, per zbatimin e dispozitave ligjore ne favor te emigrantëve shqiptarë.

### ***Aktiviteti***

Ndjekja e procesit te zbatimit te ketyre direktivave nga ana e Greqise dhe Italise si dhe te behen veretjet perkatese lidhur me masat e zbatimit.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MPJ, MIE

### ***Institucioni Zbatues***

MPJ, MIE

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2005-2006

### ***Burimet njerezore***

Burimet njerezore ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti egzistues

### ***Treguesit (nëse ka)***

-

### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Ministria e Integritimit European nuk ka staf të mjaftueshëm për ta cuar deri në fund këtë detyrë, duke konsideruar faktin që personeli është zvogëluar si rezultat i politikës së qeverisë. Edhe MPJ ka mbledhur vetëm informacione të pjesshme mbi këtë çështje.

### ***Rekomandime***

1. Qeveria duhet të rishikojë organigramën e MIE duke e përforcuar me staf të ri, duke punësuar një ekspert në çështjet migratore.
2. Të dy këto ministri, duhet të organizojnë një takim me përfaqësuesit diplomatik të Greqisë dhe Italisë për të mbledhur informacion mbi transpozicionin e direktivave të sipërcituara dhe për të nxitur aplikimin e normave më të favorshme për emigrantët shqiptarë.
3. MPJ duhet të organizojë takime të nivelit të lartë në Itali dhe Greqi për aplikimin e normave më të favorshme për emigrantët shqiptar.

## **MASA 29**

- A) Negocimi me autoritet greke mbi mundesine e uljes se tarifave te lejeve te qendrimit në Greqi duke u mbeshtetur ne parimet e acquis comunitare.
- B) Rishikimi i mundesise per uljen e tarifave lidhur me legalizimin e dokumentave neper Perfaqesite Shqiptare ne bote.

### ***Aktiviteti***

- 1. Vendosja e kontakteve dhe fillimi I bisedimeve me autoriitet perkatese greke.
- 2. Perfshirja e intitucioneve perkatese ne studimin per uljen e tarifave me qellim reflektimn e tyre ne favor te emigranteve.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MPJ, MPÇS

### ***Institucioni Zbatues***

- a) MPJ, MPÇS
- b) MPj dhe institucionet e linjes

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2006 – e ne vazhdim

### ***Burimet njerezore***

Burimet njerezore ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Nuk ka nevojje per buxhet

### ***Treguesit (nëse ka)***

Ulja e tarifave.

### ***Niveli i zbatimit***

- 1. E pazbatuar
- 2. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

MPJ nuk ka përfshirë aktivitetet e sipërpërmendura në programin vjetor të punës. Problemi i kostove të larta për lejet e qëndrimit është ngritur shpesh herë nga AP, në mënyrë të vecantë në lidhje me ligjin Grek për të huajt, por nuk janë ndërrmarë veprime zyrtare nga Qeveria Shqiptare.

### **Rekomandime**

1. MPJ, nëpërmjet Ambasadës Shqiptare në Greqi, do të duhet sa më shpejt, të vendosë kontaktet e nevojshme me autoritetet Greke, për të kërkuar trajtimin e emigrantëve Shqiptar nga ligji për të huajt, në konformitet me standartet europiane.
2. Praktikrat e mira mbi këtë çështje, do të duhen të kërkohen për përpunimin e analizës mbi mundësitë e reduktimit të kostove, për tu përdorur në bisedimet me vendet pritëse.

### **MASA 30**

Negocimi per te nenshkruar marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen sociale te emigranteve me vendet pritese me qellim qe ata te trasferojne sigurimet shoqerore edhe ne Shqiperi.

#### ***Aktiviteti***

Nenshkrimi dhe ratifikimi i ketyre marreveshjeve me vendet pritese te emigranteve, si psh. Itali, Greqi Rumani etj.

#### ***Kerkesa paraprake***

-

#### ***Institucioni pergjegjes***

MPJ, MPCŞ, ISSH

#### ***Institucioni Zbatues***

MPJ, MPCŞ, ISSH

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. 2006 per Rumania
2. 2008-2010 per Greqine dhe Italine

#### ***Burimet njerezore***

Burimet njerezore ekzistuese

#### ***Buxheti ne Total***

Buxheti egzistues

#### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i marreveshjeve te nenshkruara

#### ***Niveli i zbatimit***

1. E zbatuar
2. *Jashtë objektit të raportit*

#### ***Konsiderata***

1. Marrëveshja me Rumaninë u firmos dhe ratifikua në 2006.

#### ***Rekomandime***

-

## **MASA 31**

Mbledhja e kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore

### **Aktiviteti**

Neshkirmi i marreveshjeve ndermjet Institutit te Sigurimeve Shoqerore dhe bankave.

### **Kerkesa paraprake**

Identifikimi i vendeve perkatese

### **Institucioni pergjegjes**

MPCŞ, ISSH

### **Institucioni Zbatues**

MPCŞ, ISSH

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

2005 e në vijim

### **Burimet njerezore**

Burimet njerezore ekzistuese

### **Buxheti ne Total**

-

### **Treguesit (nëse ka)**

Numri i marreveshjeve te nenshkruara

### **Niveli i zbatimit**

E zbatuar

### **Konsiderata**

Është firmosur një marrëveshje midis ISSh dhe një dege të Bankës Amerikane në Greqi. ISSh ka pajisur emigrantët Shqiptar në Greqi me informacione në lidhje me këtë çështje. 3000 emigrantë po përfitojnë aktualisht nga ky shërbim. Arsye teknike, bëjnë sot të vështirë marrëveshje të njëjta me banka të tjera, por si rezultat i zhvillimeve të fundit, një marrëveshje e tillë me një bankë në Itali është tashmë e planifikuar.

### **Rekomandime**

-

## ***B. Emigracioni dhe zhvillimi i Shqipërisë***

### ***B.1.2 Mobilizimi i komunitetit shqiptar jashte vendit***

#### ***MASA 32***

Bashkimi i komuniteteve dhe organizatave shqiptare ne bote ne nje diaspore te vetme me qellim zhvillimin e Shqiperise.

#### ***Aktiviteti***

1. Kryerja e nje studimi te thelluar mbi dinamiken dhe zhvillimin e komuniteteve shqiptare ne bote.
2. Percaktimi i shteteve ku duhet vepruar me perparesi nga politikat per Diasporen.
3. Krijimi dhe perditesimi ne internet i nje banke të dhënash me të gjitha shoqatat shqiptare ne bote, ku te pasqyrohen te dhenat e ketyre organizatave dhe vendosja e saj ne faqen e internetit.
4. Krijimi dhe perditesimi ne internet i një banke të dhënash të gazetave, faqeve te internetit, radiove dhe televizioneve te diaspores, që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikat kombëtare mbi diasporën.
5. Krijimi i nje Gazete Elektronike periodike per Diasporen e cila do t'u drejtohet te gjithe komuniteteve Shqiptare ne bote.
6. Inkurajimi dhe mbeshtetja e krijimit te grupeve/shoqatave te vecanta te emigranteve shqiptare ne baze te interesave, profesioneve te perbashketa, apo vendndodhjes gjeografike.
  - Krijimi i lehtesirave si psh botimi ne Gazeta apo ne faqe interneti e informacioneve qe mundesojne krijimin e grupeve profesionale/interesash.
  - Vendosja e kontakteve midis grupeve homologe ne vende te ndryshme.

#### ***Kerkesa paraprake***

2/3/4/5/6 Perfundimi i Studimit ne piken 1.

#### ***Institucioni pergjegjes***

Instituti Kombetar i Diaspores dhe Migracionit.

#### ***Institucioni Zbatues***

Instituti Kombetar i Diaspores dhe Migracionit.

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. 2006
2. 2006
3. Fundi i 2006 dhe ne vazhdim perditesimi
4. Fundi i 2006 dhe ne vazhdim perditesimi
5. Fundi i 2006 dhe ne vazhdim perditesimi
6. Fundi i 2006 dhe ne vazhdim

#### ***Burimet njerezore***

1. Dy (2) eksperte.
2. Burimet Ekzistuese.
- 3/4/5- Nje specialist.
6. Burimet Ekzistuese.

#### ***Buxheti ne Total***

1. 20.000 euro.
2. Buxheti ekzistues.
3. Buxhet ekzistues.
4. Buxheti ekzistues 2000 euro ne vit per Gazeten dhe 6000 euro ne vit per specialistin. (40 000 euro ne total) qe do te merret me 3/4/5/6.

5. Buxheti ekzistues.
6. Burimet ekzistuese

### ***Treguesit (nëse ka)***

1. Perfundimi dhe botimi i studimit.
2. --
3. Numri i shoqatave te regjistruara ne banken e te dhenave.
4. Numri i mediave te regjistruara ne banken e te dhenave.
5. Numri i periodeve te botuar.
6. Numri i shoqatave profesionale/grupeve te interesave te krijuara dhe i binjakezimeve me ato homologe ne vende te tjera.

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar
3. E pazbatuar
4. E pazbatuar
5. E pazbatuar
6. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Nuk është përpunuar akoma Studimi “Mbi dinamikat dhe zhvillimin e Diasporës Shqiptare” nga i sapokrijuari IKD. IKD ka mbledhur vetëm informacione të pjesshme, që nuk janë përpunuar në një raport të përgjithshëm. Si pasojë e mosrealizimit të këtij aktiviteti paraprak, nuk ka qenë e mundur të realizohen edhe aktivitetet e tjera të parashikuara në këtë masë

### ***Rekomandime***

1. Në Buxhetin e Shtetit 2007, do të duhej të parashikoheshin financim për dy ekspertët për realizimin e studimit;
2. IKD duhet të përpunojë sa më parë termat e referimit për studimin, sikurse në bashkëpunim me DAP, duhet të përpunojë përshkrimin e punës për të dy ekspertët që duhen punësuar për këtë qëllim.
3. IKD, duhet të kompletojë mbledhjen e informacioneve në lidhje me shoqatat jashtë vendit, me të dhënat e tyre, të gazetave, të faqeve te internetit, radiove dhe kanaleve televizive të Diasporës, në mënyrë që të zbatojë aktivitetet e tjera të parashikuara nga kjo masë.

### **MASA 33**

Organizimi në Tiranë i Kongresit të parë të Diasporës Shqiptare me qëllim shqyrtimin e politikave aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, ku me prioritet do të shqyrtohen çeshtje si ruajtja e gjuhës dhe kultures, fenomeni i ikjes së trurit dhe investimet në shqipëri.

#### ***Aktiviteti***

1. Promovimi i idesë për mbajtjen e Kongresit të Diasporës brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet informimit të komunitetit Shqiptar në bote mbi këto aktivitete me anë të: a) botimit të fletëpalosjeve, b) broshurave, c) revistave apo materialeve të tjera reklamuese për të nxitur interesin dhe pjesëmarrjen në Kongres.
2. Identifikimi i burimeve njerëzore dhe parashikimi në buxhet i burimeve financiare si dhe fillimi i një fushate për mbledhjen e fondeve për mbajtjen e kongresit.
3. Mbajtja e Kongresit në Tiranë.

#### ***Kërkesa paraprake***

1. Realizimi i masave në pikën 32.

#### ***Institucioni përgjegjës***

Instituti Kombëtar i Diasporës dhe Migracionit.

#### ***Institucioni Zbatues***

Instituti Kombëtar i Diasporës dhe Migracionit.

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. 2006-2007
2. 2006
3. 2007-2008

#### ***Burimet njerëzore***

1. Burimet Ekzistuese.
2. Burimet Ekzistuese.
3. Për t'u identifikuar në baze të aktivitetit Nr 33(2).

#### ***Buxheti në Total***

1. a) 100000 fletëpalosje-25000 euro.  
b) 5000 broshura- 5000 euro;  
c) 5000 euro materiale të tjera reklamuese.
2. Burimet Ekzistuese.
3. Për t'u identifikuar në baze të aktivitetit Nr 33(2).

#### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i Pjesëmarrësve në Kongres.

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar
3. Jashtë objektit të raportit

### ***Konsiderata***

Nuk është bërë asnjë publicitet gjatë vitit 2006 edhe pse Kongresi për Diasporën është nga prioritetet për punën e IKD.

### ***Rekomandime***

1. IKD duhet të përcaktojë detajet për fushatën promovionale, në mënyrë të vecantë afatet e realizimit dhe përmbajtjen e fletpalosjeve dhe broshurave.
2. IKD duhet të përfshijë aktivitetet e parashikuara si në programin e punës për 2007 ashtu edhe në vetë buxhetin e saj.

## **MASA 34**

Percaktimi i nje Stukture Perfaqesuese te Diaspores.

### ***Aktiviteti***

1. Identifikimi i menyres se si do te zgjidhet Struktura Perfaqesuese e Diaspores, statusit dhe kompetencave te saj.
2. Zgjedhja dhe funksionimi i Perfaqesise se Diaspores.

### ***Kerkesa paraprake***

1. Perfundimi i studimit ne piken 32 (1).
2. Organizimi i Kongresit te Diaspores ne 2007-2008.

### ***Institucioni pergjegjes***

Instituti Kombetar i Diaspores dhe Migracionit.

### ***Institucioni Zbatues***

Instituti Kombetar i Diaspores dhe Migracionit.

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. 2007-2008
2. 2008-2010

### ***Burimet njerezore***

1. Burimet Ekzistuese
2. Per t'u llogaritur pas identifikimit te struktures perfaqesuese.

### ***Buxheti ne Total***

1. Burimet Ekzistuese
2. Per t'u llogaritur pas identifikimit te struktures perfaqesuese.

### ***Treguesit (nëse ka)***

Zgjedhja e perfaqesuesve te Diaspores.

### ***Niveli i zbatimit***

1. Jashtë objektit të këtij raporti
2. Jashtë objektit të këtij raporti

### ***Konsiderata***

-

### ***Rekomandime***

-

### **MASA 35**

1.Zgjerimi zonës së trasmetimit nga RTVSH ne te gjithë vendet ku ka komunitete emigrantësh shqiptarë.

2.Inkurajimi i RTVSH te rrise numrin e programeve për diasporën.

#### ***Aktiviteti***

1.Nenshkrimi i Kontrates se Transmetimit ne Satelit me Eutelsat per Zgjerimin e zones se mbulimit.

2.Rritja e numrit te programeve per Komunitetin Shqiptar ne bote.

3. Rritja e bashkepunimit me mediat shqiptare ne bote per realizimin e programeve te perbashketa dhe per transmetimin e programeve te realizuara nga RTVSH.

4. Nenshkrimi i marreveshjeve me mediat e ne vendet pritese me qellim transmetimin prej tyre te programeve per diasporen / komunitetet shqiptare.

#### ***Kerkesa paraprake***

Identifikimi i vendeve qe nuk mbulohen nga RTVSH.

#### ***Institucioni pergjegjes***

RTVSH

#### ***Institucioni Zbatues***

RTVSH. Instituti Kombetar i Diaspores dhe Migracionit

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1 .2006-2007

2. 2006 ne vazhdim.

3. 2006 ne vazhdim.

4. 2006 ne vazhdim.

#### ***Burimet njerezore***

1. Burimet ekzistuese.

2. Burimet Ekzistuese.

3. Burimet Ekzistuese.

4. Burimet Ekzistuese

#### ***Buxheti ne Total***

1. 220.000 mije euro ne vit per Ameriken dhe Australine.

2. 10 mije euro per nje program ne vit (4 programe 50.000 euro).

3. Burimet Ekzistuese.

4. Burimet Ekzistuese.

#### ***Treguesit (nëse ka)***

1. Rritja e zones se mbulimit

2. Numri i programeve te perbashketa.

3. Numri i programeve per diasporen te shfaqura ne mediat e vendeve pritese

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar
3. E pazbatuar
4. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Edhe pse RTVSH ka zhvilluar në vite aktivitete të orientuara në fushën e migracionit, këto të fundit, nuk janë zhvilluar në përputhje me aktivitetet e parashikuara në PKVM. Kështu, RTVSH është në fazën e lidhjes së kontratave për shpërndarjen e sinjalit në Amerikën e Veriut (SHBA dhe Kanada) si dhe në shqyrtimin e ofertave për transmetimin e RTVSH – së në internet.

RTVSH, sidomos kanali satelitor i RTVSH – së, ka një game të gjere e të përditshme të programeve që kanë të bëjnë me çështjet e migracionit. Përsa i përket bashkëpunimit me media të tjera, RTVSH ka një eksperiencë me programin “Pasaportë”, realizuar në bashkëpunim me shoqatën e emigrantëve shqiptarë “Skenderbeu” në Britaninë e Madhe, mbi jetën e emigrantëve shqiptarë në këtë vend. Ka munguar bashkëpunimi i RTVSH me institucionet e tjera, në mënyrë të veçantë me IKD.

### ***Rekomandime***

1. RTVSH duhet të organizojë takime periodikë me IKD për të përcaktuar subjektet me interes më të madh për programet mbi Diasporën Shqiptare.
2. RTVSH, në bashkëpunim me IKD, duhet të vendosë kontakte me ambasadat në Tiranë, për të filluar procedurat për nënshkrimin e marrëveshjeve me vendet kryesore pritëse, për transmetimin e programeve mbi Komunitetet Shqiptare në Diasporë.

## **MASA 36**

Krijimi i kushteve per arsimimin e emigranteve ne gjuhen ametare (me prioritet Greqia dhe Italia).

### ***Aktiviteti***

1. Identifikimi i nevojave per kurse te gjuhes shqipe ne vendet pritese (mbeshtetur ne studimin e mases 41.aktiviteti 1).
2. Hartimi i kurikulave standarte per mesimdhenien ne gjuhen shqipe per emigrantet / femijte e emigranteve ne bote.
3. Sigurimi i teksteve shkollore te nevojshem.
4. Trajnimi i mesuesve qe do te japin mesim ne kurset qe do te krijohen per emigrantet.
5. Nenshkrimi i marreveshjeve te bashkepunimit me institucionet arsimore ne vendet pritese per hapjen e kurseve ne gjuhen shqipe ne shkollat / ambientet edukative ekzistuese ne keto vende.

### ***Kerkesa paraprake***

1. Perfundimi i raportit ne masen 32 pika 1ku te jene identifikuar:
  - a) numri i kurseve ekzistuese ne gjuhen shqipe;
  - b) numri i femijeve shqiptare per te cilet duhet te botohen tekste shkollore nga MASH.

### ***Institucioni pergjegjes***

1. Instituti Kombetar i Diaspores dhe Migracionit.
- 2.MASH
- 3.MASH
- 4.MASH

### ***Institucioni Zbatues***

1. Instituti Kombetar i Diaspores.
2. MASH
3. MASH
4. MASH
5. MASH, Instituti Kombetar i Diaspores dhe Migracionit.

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. 2006
2. 2006.
3. 2006-2007.
4. 2006-2007
5. 2006 ne vazhdim.

### ***Burimet njerezore***

1. Burimet Ekzistuese.
2. Burimet Ekzistuese.
3. Burimet Ekzistuese.

4. Burimet Ekzistuese.
5. Burimet Ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

1. Shih masen 32 aktiviteti 1.
2. Burimet Ekzistuese.
3. 1.8 million euro per 300.000 kopje libra.
4. 20.000 euro
5. Nuk ka nevojë per buxhet.

### ***Treguesit (nëse ka)***

- Numri i kurseve te reja te hapura.
- Numri i teksteve shkollore te botuara per emigrantet.
- Numri i mesuesve te trajnuar per mesimdhënie ne gjuhen shqipe.
- Numri i marreveshjeve te nenshkruara.

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E zbatuar
3. E zbatuar
4. E zbatuar
5. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Janë redaktuar curricula standart nga MASH. MASH ka krijuar një video specifike me përmbajtje një kurs të gjuhës shqipe për shqiptarët jashtë, e cila, është shpërndarë në dy shkolla në SHBA dhe në një shkollë në Greqi. Është planifikuar gjithashtu që kjo video të shpërndahet edhe në shtete të tjera me një prani të madhe shqiptarësh. Është publikuar dhe shpërndarë edhe një libër specific, si dhe është realizuar një kurs formimi për mësuesit. Në të kundërt, nuk janë nënshkruar marrëveshje bashkpunimi me institucione arsimore në vendet pritëse.

### ***Rekomandime***

1. MASH dhe IKD, duhet të krijojnë një grup pune të përbashkët për të saktësuar nevojat për arsimim, të curricula dhe librave për kurset e gjuhës në vendet pritëse.
2. IKD duhet të përshpejtojë procedurat për finalizimin e studimit të parashikuar në masën 32, duke përfshirë të dhënat mbi numrin e kurseve ekzistuese në gjuhën shqipe për tu realizuar dhe numrin e fëmijve shqiptarë për të cilët duhen publikuar librat.
3. MASH në bashkëpunim me IKD, duhet të vendosë të gjithë kontaktet e nevojshme me ambasadat e pranishme në Tiranë për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione arsimore në vendet pritëse, në lidhje me krijimin e kurseve të gjuhës shqipe në strukturat apo shkollat arsimore ekzistuese.

## **MASA 37**

Tërheqja e diasporës shqiptare në Shqipëri për qëllime turizmi dhe investimi.

### ***Aktiviteti***

1. Botimi ne Gazeten Elektronike, ne faqen e internetit ne Institutin Kombetar te Diaspores dhe Migracionit dhe  ebsitet e komuniteteve shqiptare ne bote, hartimi dhe shperndarja e broshurave, fletpalosjeve me informacion mbi Turizmin Shqiptar dhe mundesite e Investimeve ne Shqiperi.

2. Organizimi i takimeve apo "diteve te Shqiperise" si dhe aktivitete te tjera per Diasporen Shqiptare per reklamimin e turizmit shqiptar edhe lehtesirat lidhur me investimet ne Shqiperi.

### ***Kerkesa paraprake***

Identifikimi i komuniteteve Shqiptare me interes ne drejtim te zhvillimit te turizmit dhe ne fushen e investimeve ne vend (mbeshtetur ne rezultatet e studimit piken 32.1).

### ***Institucioni pergjegjes***

M.Turizmit;

### ***Institucioni Zbatues***

M.Turizmit, MPJ, Instituti Kombetar i Diaspores.

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2006 dhe ne vazhdimesi.

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

1. Burimet Ekzistuse te Ministrise se Turizmit.

2.25.000 euro per nje "dite te Shqiperise"– 100000 euro ne total.

### ***Treguesit (n ese ka)***

Numri i takimeve/ diteve te Shqiperise te organizuara.

Rritja e numrit te shqiptareve te diaspores qe vijne per qellime turizmi apo investime ne vend.

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

MTKRS nuk ishte n e dijene t  PKVM. P r k t  arsye, asnj  veprim nuk  sht  nd rmar 

nga kjo Ministri për zbatimin e kësaj mase.

***Rekomandime***

1. KNM duhet edhe njëherë të deklarojë vullnetin e tij për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin.
2. IKD duhet të përshpejtojë procedurat për finalizimin e studimit të parashikuar në masën 32, në mënyrë që të bëjë të disponueshëm për MTKRS të dhënat e nevojshme për komunitetet shqiptare të interesuar për turizmin dhe investimet në Shqipëri;
3. Mbi bazën e studimit të parashikuar në masën 32, MTKRS, në bashkëpunim me IKD, duhet të planifikojë një kalendar takimesh “të ditëve shqiptare” për tu realizuar gjatë vitit 2007 në vendet pritëse, duke përcaktuar sa më parë përmbajtjen dhe përfituesit e tyre.

## ***B. Emigracioni dhe zhvillimi i Shqipërisë***

### ***B.1.3 Orientimi i dërgesave të emigrantëve drejt investimeve në biznes***

#### ***MASA 38***

Perpilimi i pjesës së dërgesave të emigrantëve në Planin Kombëtar të Veprimit.

#### ***Aktiviteti***

Analiza e raportit përfundimtar të studimit dhe plotësimi i masave mbi dërgesat e emigrantëve

#### ***Kerkesa paraprake***

Studimi i kryer nga IOM, I përfunduar në fund të Qershorit 2005

#### ***Institucioni përgjegjës***

Per t'u identifikuar.

#### ***Institucioni Zbatues***

Per t'u identifikuar.

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

Korrik 2005

#### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese.

#### ***Buxheti në Total***

Burimet Ekzistuese.

#### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i masave të Planit të Veprimit për dërgesat e emigrantëve, të cilat do të plotësohen në këtë studim.

#### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

#### ***Konsiderata***

Në kuadrin e projektit “Krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Migracionit Shqiptar: hartimi i Strategjisë Kombëtare të Migracionit dhe Planit të saj të veprimit” (financuar nga Komisioni Europian nëpërmjet Programit CARDS 2001), është bërë një studim mbi “Konkurrencën e dërgesave në para të emigrantëve shqiptarë”, shoqëruar me një plan veprimi për menaxhimin e dërgesave, i cili u vlerësua nga MPCSShB si shumë teorik e i pazbatueshëm. Duke konsideruar rëndësinë e dërgesave për ekonominë shqiptare, mos zbatimi i kësaj mase është, aktualisht, një boshllëk serioz në PKVM. Për pasojë, IOM me mbështetjen financiare të ILO-s dhe të Ministrisë së Jashtme Italiane, po realizon një projekt në lidhje me përpunimin dhe aprovimin zyrtar të kësaj pjese të PKVM. METE

është përfaqësuesi kryesor i Qeverisë Shqiptare. Është e vështirë të kuptohet pse Qeveria Shqiptare nuk ka qënë në gjëndje të përgatiste në mënyrë autonome masën e sipërpërmendur të PKVM, duke përdorur studimin mbi dërgesat për të cilin janë shpenzuar afro 30 mijë euro, por ka akoma nevojë për asistencë ndërkombëtare dhe për një projekt të ri për këtë gjë, ndoshta me një humbje të kotë kohe dhe fondesh të donatorëve. Këta të fundit, do të mund të përdreshin më efektivisht për zbatimin e PKVM në përgjithësi.

### ***Rekomandime***

1. KNM duhet të identifikojë organizmin/organizmat përgjegjës për zbatimin e politikës për dërgesat, pasi një lider për këtë sektor është i nevojshëm;
2. Në një nga takimet e tij të radhës, KNM duhet të nënvizojë rëndësinë e çështjes së dërgesave dhe të shtyjë të interesuarit të kompletojnë masat respektive të PKVM;
3. Në zbatimin e projektit të ri, institucionet e përfshira duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me IOM pa humbur pronësinë e materialit të përpunuar.

## ***B Emigracioni dhe zhvillimi i Shqipërisë***

### ***B.2. Hartimi i politikave të pershtatshme për emigracionin***

#### ***B.2.1.1. Informimi mbi mundësitë e emigracionit***

##### ***MASA 39***

Zhvillimi i një politike informuese për migracionin e cila duhet të drejtohet çdo kategori të migrantëve dhe jo vetëm emigrantëve për motive punësimi.

##### ***Aktiviteti***

1. Caktimi i një personi kontakti në çdo ministri të përfshirë në këtë proces dhe institucionet përkatëse. Këto persona kontakti do të jenë përgjegjës për sigurimin e informacionit rreth emigracionit imigracionit dhe diasporës.
2. Krijimi dhe mirëmbajtja e një faqeje interneti [ëëë.migrantinfo.gov.al](http://ëëë.migrantinfo.gov.al) me informacion të detajuar mbi migracionin.
  - a. Personat e kontaktit do të përzgjedhin informacionin e duhur, sipas fushës që mbulon puna e tyre, dhe gjithashtu do ta azhurnojnë atë.
  - b. Ekspertët IT të secilës prej ministrive të linjës apo institucionit të përfshirë do të mund të përdorin këtë faqe interneti për të shtuar informacionin e siguruar nga personat e kontaktit.
  - c. Të krijohet lidhja e faqeve të internetit të çdo ministrie apo instituti me faqen e internetit për migracionin.
3. Planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese qeveritare mbi:
  - Çështje që kanë të bëjnë me emigracionin dhe imigracionin.
  - Promovimin në shkallë të gjere të rregjistrimit të emigrantëve dhe synimeve të tij (ref masa 41)
  - Ekzistenca e burimeve informative mbi migracionin (sportelet e migracionit, faqe interneti etj.) me anë të:
    - a) Organizimit të publicitetit në TV dhe Radio.
    - b) Botimit dhe shpërndarjes së pamfleteve dhe broshurave.
    - c) Organizimit të fushatave në shkollat e Universiteteve në të gjithë vendin, dhe vecanerisht në ato zona që karakterizohen nga shifra të larta emigracioni.

##### ***Kerkesa paraprake***

**1.** Krijimi i akteve normative (regullore) mbështetur në Ligjin nr. 9000 "Për funksionimin e Keshillit të Ministrave" me qëllim që të ndryshojë rregullorja për çdo ministri lidhur me detyrat e reja të percaktuara për një ekspert/specialist, i cili merret me politiken e informimit për migracionin.

**2.b.** Të sigurohet Përvoja Teknike (Ekspert IT) për përfshirjen e informacioneve në faqen e internetit; gjithashtu duhen organizuar trainime të duhen siguruar paisje.

**2.c.** Duhen vënë në funksionim faqet e internetit të çdo ministrie linje dhe çdo institucioni të përfshirë.

##### ***Institucioni përgjegjës***

MPCS, deri në krijimin e agjensisë së parashikuar në masën 62

### ***Institucioni Zbatues***

Ministrit e linjes dhe institucionet e perfshira.

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. Qershor 2005
2. Qershor 2005 dhe ne vazhdimesi

### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

1. Buxheti ekzistues.
2. Buxheti ekzistues.
3. Te perlllogaritet sipas planit per fushaten informuese.

### ***Treguesit (nëse ka)***

-

### ***Niveli i zbatimit***

1. E zbatuar
2. Pjesërisht e zbatuar
3. E zbatuar

### ***Konsiderata***

Në secilën ministri të përfshirë dhe në institucionet e rëndësishme, janë emëruar pikat e kontaktit. Është krijuar faqja e internetit, por ajo nuk përmban informacione të plota. Në fakt, ka patur një sërë problemesh teknike dhe sipas MPCSShB, aktualisht, është e pamundur azhurnimi i informacioneve që përmban kjo faqe. Nëpërmjet masmediave, qeveria ka zhvilluar një fushatë informuese. Është promovuar, për herë të parë, regjistrimi i emigrantëve, në mënyrë të vecantë të emigrantëve që kanë dokumenta emigrimi dhe të rikthyerve. Regjistrimi i tyre do të varet, përveç të tjerave, nga implementimi i projektit mbi refomën e regjistrimit civil.

### ***Rekomandime***

1. MPCSShB duhet të bëjë të mundur që një ekspert IT, të zgjidhë problemet teknike për përdorimin e faqes se internetit dhe duhet të koordinojë azhurnimin e informacioneve që përmban faqja në fjalë.
2. Të gjitha pikat e kontaktit duhet të bashkëpunojnë me MPCSShB për azhurnimin e vazhdueshëm të kësaj faqeje.

#### **MASA 40**

Ngritja e caktimi i Sporteve të Migracionit në cilësinë e institucionit që do të merret me dhënien e informacionit për migracionin.

#### **Aktiviteti**

Krijimi i infrastruktures se nevojshme ne Zyrat Rajonale te Punesimit, duke pershire:

- a. Paisjen me kompiutera
- b. Trainimin e personelit

#### **Kerkesa paraprake**

T'i referohet mases 9, ne lidhje me ngritjen e kapaciteteve ne SHKP.

#### **Institucioni pergjegjes**

MPCS,

#### **Institucioni Zbatues**

MPCS, SHKP

#### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

2006-2010

#### **Burimet njerezore**

Burimet ekzistuese

#### **Buxheti ne Total**

- 30000 Euro per 15 kompjutera
- 14000

#### **Treguesit (nëse ka)**

-

#### **Niveli i zbatimit**

Pjesërisht e zbatuar

#### **Konsiderata**

Kjo masë u realizua në disa zyra rajonale pilot.

#### **Rekomandime**

1. MPCSShB në bashkëpunim me ShKP, duhet të vlerësojë përvojën e zyrave rajonale pilot dhe të përdorë praktikën më të mirë për të krijuar një sistem eficient në zyrat që mbeten;
2. MPCSShB duhet të parashikojë buxhetin e nevojshëm për blerjen e mjeteve të nevojshme për realizimin e kësaj mase.
3. MPCSShB, në bashkëpunim me ITAP duhet të përcaktojë curriculat për formimin e personelit që do të punësohen në kuadrin e implementimit të kësaj mase.

## ***B. Emigracioni dhe Zhvillimi I Shqipërisë***

### ***B.2.1.2. Regjistrimi i emigrantëve***

#### ***MASA 41***

Zgjerimi i Rregjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile me të dhëna për emigrantët.

#### ***Aktiviteti***

1. Te krijohet baza ligjore për regjistrimin e emigrantëve në Ligjin Për Gjendjen Civile dhe të saktësohen elementet teknike në nen ligje, në baze të kriterëve të mëposhtme (ref. Masa 58-6):

- a) Qytetarët të jenë të detyruar me ligj, për të deklaruar largimin e tyre nga vendi, në Zyrën e gjendjes civile, nëse mendojnë të largohen për 12 muaj ose më shumë.
- b) Rregjistrimi i adresës së tyre jashtë vendit me anë të ambasadave apo konsullatave, të jetë i detyrueshëm për emigrantët e rinj, pas një date e cila është për të caktuar.
- c) Rregjistrimi i emigrantëve të cilët janë larguar para datës së caktuar në aktivitetin b, është vullnetar.
- d) Mundësia për të votuar jashtë vendit me anë të ambasadave dhe konsullatave e (përmendur në masën 58-4) do të realizohet në baze të regjistrimit.

2. Identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit të infrastrukturës së duhur në baze të studimit të fizibilitetit.

3. Përfundimi i sistemit dhe venia në funksionim e tij.

#### ***Kërkesa paraprake***

Kompiuterizimi i regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile.

Studimi i Fizibilitetit i kryer nga IOM, i përfunduar në fund të Qershorit 2005.

#### ***Institucioni përgjegjës***

MPVD

#### ***Institucioni Zbatues***

MPVD, MPJ, MPCS,

#### ***Afati (Kohezigjatja Finalizimi)***

1. 2006
2. Dhjetor 2005
3. 2007

#### ***Burimet njerezore***

1. Burimet ekzistuese
- 2/3. Të planifikohen në baze të studimit.

#### ***Buxheti në Total***

1. Në baze të burimeve ekzistuese financiare.
2. Të përlogaritet në Studimin e Fizibilitetit

#### ***Treguesit (nëse ka)***

-

***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar
3. *Jashtë objektit të raportit*

***Konsiderata***

Edhe pse studimi i IOM është finalizuar në 2005, kjo masë mbetet akoma një projekt dhe nuk janë zhvilluar akoma veprime konkrete për zbatimin e saj nga ana e organizmit përgjegjës.

***Rekomandime***

1. MB, në bashkpunim me MPJ dhe MPCSShB, duhet të krijojnë një grup pune të përbashkët për të vlerësuar studimin e përgatitur nga IOM, në mënyrë që të krijohet baza ligjore për rregjistrimin e emigrantëve në Ligjin “Për gjendjen Civile” dhe të rregullohen aspektet specifike në rregulloret përkatëse.

## **MASA 42**

Mbledhja e të dhënave shtesë në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, që duhen për menaxhimin e migracionit, me anë të regjistrimit në ambasada dhe shërbime konsullore.

### **Aktiviteti**

1. Përcaktimi i të dhënave që duhen mbledhur.
2. Identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit e infrastruktures së duhur sipas përfundimeve të Studimit të Fizibilitetit, përmendur në masën 41.
3. Përfundimi i sistemit dhe venia në funksionim e tij.

### **Kërkesa paraprake**

Studimi i Fizibilitetit i kryer nga IOM, i përfunduar në fund të Qershorit 2005

### **Institucioni përgjegjës**

MPJ, MPCs,

### **Institucioni Zbatues**

MPCs, MPJ.

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

1. Maj 2005
2. Dhjetor 2005
3. 2007

### **Burimet njerezore**

Të përcaktohen në bazë të Studimit.

### **Buxheti në Total**

Të përlogariten në Studim.

### **Treguesit (nëse ka)**

-

### **Niveli i zbatimit**

1. E zbatuar
2. E pazbatuar
3. Jashtë objektit të raportit

### **Konsiderata**

Janë përcaktuar të dhënat që duhet të mblidhen. Studimi i IOM mbi regjistrimin e shqiptarëve jashtë është kompletuar, por deri tani nuk janë bërë përpertime nga Qeveria për përdorimin e një studimi të tillë në programimin e aktiviteteve qeveritare në këtë fushë.

### **Rekomandime**

1. MPCSShB, në bashkpunim me MPJ dhe INSTAT, duhet të krijojë një grup pune për identifikimin dhe programimin e krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së nevojshme mbi bazën e studimit të fizibilitetit të realizuar nga IOM;
2. Institucionët e mësipërme duhet të planifikojnë në buxhetin e tyre fondet e nevojshme për zbatimin e sistemit (ndihma e donatorëve mund të jetë e nevojshme).

## ***B. Emigracioni dhe Zhvillimi I Shqipërisë***

### ***B. 2.1.3 Marreveshjet dypaleshe te punesimit ndermjet Shqiperise dhe shteteve anetare te BE***

#### ***MASA 43***

Të rishikohet kuadri i marrëveshjeve egzistuese për migracionin për motive punësimi sezonal me Greqinë dhe Italinë. Te negociohen kuadret e marreveshjeve te punesimit me keto shtete. (Ne keto marreveshje duhen perfshire pjese të vecanta ne lidhje me formimin profesional, ose per to mund te diskutohet ne vecanti.

#### ***Aktiviteti***

Hyrja në diskutime me Greqinë dhe Italinë duke dërguar një grup ekspertësh, dy ose tre here në vit, që të vizitojnë Greqinë dhe Italinë.

#### ***Kerkesa paraprake***

-

#### ***Institucioni pergjegjes***

MPCS, MPJ

#### ***Institucioni Zbatues***

MPCS, MPJ

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

Me Italine: 2006 (objektive)

Me Greqine: 2006/2007 (Objektive)

#### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistuese

#### ***Buxheti ne Total***

Burimet ekzistuese

#### ***Treguesit (nëse ka)***

Kontakte me qeveritë përkatëse.

#### ***Niveli i zbatimit***

E zbatuar

#### ***Konsiderata***

Qeveria është e impenjuar në këto bisedime.

#### ***Rekomandime***

-

## **MASA 44**

Ne bashkepunim me Greqine dhe Italine, te ndermerren projekte te vecante pilote per te lehtesuar zbatimin e marreveshjeve te punesimit. Te perfitohet nga legjislacioni provizor dhe I vecante I vendeve pritese, qe kane mungese krahu pune.

### **Aktiviteti**

1. Te vendosen kontakte me Italine (MPCS) per te hartuar nje project per perzgjedhjen dhe trainimin ne Shqiperi dhe me pas punesimin ne Itali, te nje numri te vecante punetoresh Shqiptare, ne perputhje me nenin 23(ref: te drejtat e vecanta te ligjit italian Per te huajt 286/98)
2. Te promovohet nje projekt pilot per punesimin e Infermiereve Shqiptare ne tregun Italian te punes sipas nenit 27 parag. r-bis<sup>2</sup> te ligjit italian Per te huajt 286/98.
3. Te inkurajohen projekte te ngjashme edhe me Greqine.

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni pergjegjes**

MPCS,

### **Institucioni Zbatues**

MPCS, MPJ

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

1. Korrik-Dhjetor 2005
2. Ne Vazhdimesi

### **Burimet njerezore**

Sipas parashikimeve ne baze te projektit pilot.

### **Buxheti ne Total**

Sipas parashikimeve ne baze te projektit pilot.

### **Treguesit (nëse ka)**

Numri i projekteve pilote.

### **Niveli i zbatimit**

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar
3. E pazbatuar

### **Konsiderata**

Qeveria Shqiptare nuk ka patur sukses në realizimin e kësaj mase.

---

### ***Rekomandime***

1. MPCSShB duhet të krijojë kontakte me ministrinë homologe në Itali dhe Greqi nëpërmjet kanaleve diplomatike të këtyre vendeve në Tiranë ose atyre Shqiptare në këto vende, me qëllimin, për të përgatitur së bashku kushtet për zbatimin e këtyre projekteve pilotë;
2. Për sa i takon kurseve të formimit që duhen zhvilluar në Shqipëri, mund të kërkohet ndihmë edhe nga donatorë të ndryshëm.

## **MASA 45**

Të nxitet migrimi qarkullues ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të treta me anë të masave favorizuese për lëvizshmërinë e emigrantëve shqiptarë nëpërmjet

A. të drejtës për t'u kthyer në vendin pritës sipas statusit European për rezidentët afatgjatë në rast largimi për më shumë se një vit<sup>3</sup>.

### **Aktiviteti**

Negocimi i marrëveshjeve bilaterale, duke i dhënë përparësi Greqisë dhe Italisë.

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni përgjegjës**

MPJ

### **Institucioni Zbatues**

MPJ MPCS

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

2006 në vazhdim

### **Burimet njerezore**

Burimet Ekzistuese

### **Buxheti në Total**

Buxheti ekzistues

### **Treguesit (nëse ka)**

Numri i marrëveshjeve.

### **Niveli i zbatimit**

E pazbatuar

### **Konsiderata**

Sipas MPJ, migracioni qarkullues nuk është aktualisht midis prioriteteve të qeverive greke dhe italiane. Në këto kushte, nuk janë duke u zhvilluar bisedime për marrëveshje bilaterale në këtë fushë.

### **Rekomandime**

1. MPJ, në bashkpunim me MPCSShB, duhet të organizojnë takime të nivelit të lartë me autoritete greke dhe italiane, në mënyrë që të nxisin aprovimin e masave që favorizojnë lëvizshmërinë e emigrantëve shqiptar.

## **MASA 46**

Të kërkohen mundësi të mëtejshme për të bërë marrëveshje me vende të tjera sipas interesave më të mira reciproke dhe sipas nevojave.

### ***Aktiviteti***

Të vendoset një pikë kontakti brenda MPJ për vlerësimin dhe monitorimin e gjendjes së tregjeve të huaja të punës dhe me pas ky informacion t'i kalohet MPCSS.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MPJ (Konsullatat)

### ***Institucioni Zbatues***

MPCS, MPJ,

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2005 ne vazhdim

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti ekzistues

### ***Treguesit (nëse ka)***

Raporte per tregjet e huaja të punës.

### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Në MPJ, nuk është akoma e qartë se cila është pika reale e takimit për zbatimin e kësaj mase. Si rrjedhojë, asnjë informacion/raport i është dhënë MPCSShB në këtë fushë. Kordinimi dhe bashkpunimi midis MPCSShB dhe IKD, është vecanërisht i pakët.

### ***Rekomandime***

1. MPJ duhet të qartësojë brenda strukturës së saj, se cili është organizmi përgjegjës për të ndjekur zhvillimet e tregjeve të huaja të punës dhe duhet ta emërojë zyrtarisht si pikë takimi.
2. Struktura e përcaktuar si pikë takimi, për të realizuar masën në fjalë, duhet sa më shpejtë të vihet në kontakt me përfaqësitë diplomatike shqiptare në vendet fqinje por edhe më gjerë, për të mbledhur informacionet e nevojshme për tregjet respektive të punës dhe për vendosjen e kontakteve me institucionet që lidhen me botën e punës.

## ***B. Emigracioni dhe Zhvillimi I Shqipërisë***

### ***B.2.1.4 Studentët ne shtetet anetare te BE-se***

#### ***MASA 47***

Orientimi i programeve/donatoreve qe ofrojne bursa studimore per jashte vendit drejt fushave te ekspertizes per te cilat ka nevoje Shqiperia.

#### ***Aktiviteti***

1. Kryerja e nje studimi te thelluar mbi numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen.
2. Identifikimi fushave te studimit dhe ekspertizes per te cilat ka me shume nevoje ne Shqiperi dhe orientimi i donatoreve/programeve drejt ketyre fushave.
3. Lobimi nga autoritetet Shqiptare per perfshirjen e kushtit te kthimit ne Shqiperi per nje periudhe jo me pak se nje vit per te gjithë studentet qe marrin bursa studimi per jashte vendit ne kuader te programeve studimore te donatoreve te ndryshem per Shqiperine.

#### ***Kerkesa paraprake***

1. Ngritja e nje grupi pune per kryerjen e studimit dhe percaktimi i metodologjise se studimit.
2. Ngritja e nje Komiteti Shkencor me baze te gjere per identifikimin e fushave te ekspertizes te nevojshme per Shqiperine.

#### ***Institucioni pergjegjes***

1. MASH
2. MPCs ME
3. MASH

#### ***Institucioni Zbatues***

1. MASH, MPJ, INSTAT.
2. MASH, te gjithë Ministrite e Linjes.
3. MASH, MKRS, MPJ.

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. 2006
2. 2006
3. 2006 e ne vazhdim

#### ***Burimet njerezore***

1. nje ekspert.
2. Burimet ekzistuese.
3. Burimet ekzistuese.

#### ***Buxheti ne Total***

1. 10 000 euro.
2. BuxhetEkzistues.

### 3. BuxhetEkzistues.

#### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i programeve/donatoreve qe perfshijne kushtin e kthimit ne dhenien e bursave per studime jashte vendit.

#### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar
3. E pazbatuar

#### ***Konsiderata***

Asnjë nga aktivitetet nuk është planifikuar nga ministrinë përkatëse. As MASH, as METE nuk ishin në dijeni të kësaj mase, ndërsa MPCSShB nuk ka fonde të mjaftueshme dhe as burime njerëzore të nevojshme për zbatimin e kësaj mase. Në fakt, të gjitha ministrinë kanë mungesë personeli dhe kanë vështirësi në trajtimin e çështjeve jo rutinore.

#### ***Rekomandime***

1. MASH, në bashkpunim me MPJ (IKD) dhe INSTAT, duhet të krijojë një grup pune për të përcaktuar termat e referimit për studimin mbi numrin e studentëve shqiptarë që frekuentojnë universitete jashtë dhe fushat e studimit në të cilat po specializohen. Grupi i punës duhet të mbështesë punën e ekspertit që do të duhet të punësohet për këtë;
2. MASH duhet të parashikojë këtë aktivitet në buxhetin vjetor të saj;
3. METE duhet të marrë drejtimin për krijimin e Komitetit Shkencor me një bazë të gjerë, për identifikimin e fushave të eksperiencës më të nevojshme për Shqipërinë;

### **MASA 48**

Promovimi i programeve/donatoreve qe ofrojne bursa per studime jashte vendit per Shqiperine, si programet Tempus dhe Erasmus Mundus.

### **Aktiviteti**

Organizimi i seminareve informative ne shkollat e larta me qellim njohjen e ketyre programeve dhe procedurave te aplikimit si nga pedagoget edhe nga studentet.

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni pergjegjes**

MASH

### **Institucioni Zbatues**

MASH, Universitetet Shqiptare, Zyrat Koordinuese te programeve Shqiptare.

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

2006 e ne vazhdim ne cdo vit akademik

### **Burimet njerezore**

Burimet Ekzistuese

### **Buxheti ne Total**

6000 euro ne vit per organizimin e seminareve informative ne te gjithe universitet ne vend (30 000 euro ne total)

### **Treguesit (nëse ka)**

Numri i studenteve dhe pedagoqeve qe do te aplikojne dhe numri i aplikanteve qe do te perfitojne nga keto programe.

### **Niveli i zbatimit**

E pazbatuar

### **Konsiderata**

MASh nuk ishte në dijeni të kësaj mase dhe nuk ka planifikuar aktivitetet e parashikuara në programin vjetor të punës.

### **Rekomandime**

1. Komiteti Ndërmintor i Migracionit, duhet edhe njëherë të deklarojë vullnetin e tij për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin;
2. MASh, në bashkëpunim me përfaqësues të universiteteve shqiptar dhe Zyrat Koordinuese te programeve Shqiptare, duhet të krijojë një grup pune të përbashkët për identifikimin dhe organizimin e disa takimeve informues që mund të organizohen në fillim të cdo viti akademik
3. MASh duhet të parashikojë buxhetin e nevojshëm në rast të mungesës së asistencës nga ana e donatorëve.

## ***B. Emigracioni dhe Zhvillimi I Shqipërisë***

### ***B.2.1.5. Politika e Vizave***

#### ***MASA 49***

Negocimi me vendet ku ka nje fluks te madh studentesh (si Italia) per lehtesimin e levizjes se studenteve Shqiptare, nepermjet leshimit te vizave jo me pak se nje vit apo pershpjtimin e procedurave per dhenien e lejeve te qendrimit.

#### ***Aktiviteti***

1. Kryerja e nje raporti vleresues mbi veshtiresite e studenteve shqiptare per te ardhur lirisht ne vend dhe mbi faktoret qe ndikojne ne kete situatë.
2. Lobimi me vendet pritese (ne menyre te vecante me Italine) per marrjen e masave per te mundesuar levizjen e lire te studenteve.

#### ***Kerkesa paraprake***

- 2.Perfundimi raportit vleresues ne piken 1.

#### ***Institucioni pergjegjes***

1. MPJ
2. MPJ

#### ***Institucioni Zbatues***

- 1.MPJ, Zyra e Avokatit te Popullit.
- 2.MPJ, MEI, MASH.

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. 2006.
2. 2006 e ne vazhdim deri ne zgjidhjen e problemit.

#### ***Burimet njerezore***

- 1.Nje ekspert per kryerjen e raportit vleresues.
- 2.Burimet ekzistuese.

#### ***Buxheti ne Total***

- 1.3000 euro.
- 2.Buxhet Ekzistues.

#### ***Treguesit (nëse ka)***

- 1.Raporti vleresues.
- 2.Nryshimi/pershpjtimi i procedur. per pajisjen me dokumentacionin e nevojshem.

#### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

MPJ (IKD) nuk ka përgatitur akoma një raport vlerësimi mbi vështirësitë e ndeshura nga studentët shqiptar për tu kthyer lirisht në vendin e origjinës dhe mbi faktorë që e bëjnë më të vështirë atë, për tu përdorur si bazë për të nxitur vendet pritës që të ndërrmarin masa që lehtësojnë lëvizjen e lirë për studentët. Për pasojë edhe aktiviteti i dytë nuk është realizuar.

### ***Rekomandime***

1. MPCSShB duhet të bashkëpunojë me AP për përcaktimin e termave të referimit për raportin e vlerësimit;
2. MPJ në bashkpunim me DAP, duhet të përcaktojë përshkrimin e punës për ekspertin që duhet të punësohet për përgatitjen e raportit të vlerësimit;
3. MPJ, MI dhe MASH duhet të zhvillojnë një politikë të përbashkët për të lobuar me vendet pritëse.

## ***MASA 50***

Hyrja në diskutime me BE dhe vendet anëtare të saj për të kërkuar lehtësimin e vizave afatmesme dhe afatgjata, duke marrë parasysh që mund të ketë plotësisht heqje të tyre në të ardhmen.

### ***Aktiviteti***

Hyrja në diskutime dypalëshe diplomatike në mënyrë që të lehtësohen vizat me  
A. vende të rajonit; Serbine, Bosnian, Hercegovinen, Kroacine, Maqedonine, Bullgarine, Rumanine.

B. Vende të BE-se si, Italia, Greqi, Britania e Madhe, Belgjika, Gjermania, Holanda, Franca, Suedia

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MPJ, MIE

### ***Institucioni Zbatues***

MPJ, MIE

### ***Afati (Kohezigjatja Finalizimi)***

A. Qe nga 2005

B. 2006

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti Ekzistues.

### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i takimeve bilaterale

### ***Niveli i zbatimit***

E zbatuar

### ***Konsiderata***

Qeveria Shqiptare është impenjuar në bisedime për lehtësimin e vizave, në mënyrë të vecantë me Bashkimin Europian. Bisedimet janë zhvilluar në maj-nëntor 2006. Nga dhjetor 2006 deri në 2007 do të zhvillohen negociatat teknike. Nënshkrimi i marrëveshjes dhe ratifikimi janë parashikuar për fundin e 2007, për të hyrë në fuqi në 1 janar 2008.

### ***Rekomandime***

-

## **MASA 51**

Të bëhen përpjekje të mëtejshme për të lehtësuar trafikun kufitar duke patur parasysh rregulloren e ardhshme të BE mbi trafikun e kufirit lokal.

### **Aktiviteti**

Të negociohet dhe perfundohet marrëveshja me Malin e Zi për Kalimin e lirë të kufirit (me leter-njoftim dhe jo me pasaporta).

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni përgjegjës**

MPJ,

### **Institucioni Zbatues**

MRP, MPJ

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

2006/2007

### **Burimet njerezore**

Burimet Ekzistuese

### **Buxheti në Total**

Buxheti Ekzistues.

### **Treguesit (nëse ka)**

-

### **Niveli i zbatimit**

E pazbatuar

### **Konsiderata**

Nuk është mbyllur me Malin e Zi asnjë marrëveshje mbi kalimin e lirë në kufi. Megjithatë, një marrëveshje tjetër është firmosur, që autorizon qytetarët shqiptar të hyjnë në Mal të Zi pa vizë.

### **Rekomandime**

1. MPJ, në bashkpunim me MB duhet të përgatisë një projekt-marrëveshje mbi kalimin e lirë kufitar dhe të organizojë takime të nivelit të lartë me autoritetet malazeze, në mënyrë që të bëhet i mundur fillimi i bisedimeve për këtë çështje.

## **MASA 52**

Të lehtësohet aplikimi për viza duke përmirësuar procedurat administrative kombëtare që duhet të ndjekin qytetarët për të marrë dokumentacionin e duhur;

### ***Aktiviteti***

Identifikimi i procedurave me problematike dhe afatgjata dhe përmirësimi i tyre paralelisht me masen B.4.1 të Planit të Veprimit mbi Anti Korrupsionin.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni përgjegjës***

Per tu identifikuar.

### ***Institucioni Zbatues***

Per tu identifikuar.

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2006

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese

### ***Buxheti në Total***

Buxheti Ekzistues.

### ***Treguesit (nëse ka)***

-

### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Nuk është identifikuar asnjë organizëm përgjegjës. Një organizëm koordinimi dhe monitorimi i PKVM, që do të bënte të mundur realizimin e kësaj mase, ka munguar.

### ***Rekomandime***

1. Në takimin e tij të rradhës, KNM duhet të identifikojë institucionin përgjegjës për aplikimin e kësaj mase. Rekomandohet, duke u nisur nga fusha dhe roli i saj, që MPJ të konsiderohet si institucioni përgjegjës për zbatimin e kësaj mase.

## **MASA 53**

Lufta kunder fenomenit negative te seksereve abuzues, perpara dyerve te perfaqesive diplommatike e konsullore te huaja ne Shqiperi: psh shitja e fomulareve te aplikimit ne ambasada apo konsullata, te cilet mund te merren pa paguar.

### ***Aktiviteti***

Forcimi I kontrollit nga strukturat perkatese te policise, per zbatimin e ligjit dhe ndjekjen e ketij fenomeni.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MRP

### ***Institucioni Zbatues***

MRP, MPJ

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2005 dhe ne vazhdimesi.

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti Ekzistues.

### ***Treguesit (nëse ka)***

### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Asnjë veprim specifik është zhvilluar për zbatimin e kësaj mase.

### ***Rekomandime***

1. MB dhe në mënyrë të vecantë PK duhet të krijojnë një task force që mund të përfshijë gjyqtar dhe prokurorë me qëllim studimin dhe ndërmarrë veprime kundër veprimeve të tilla.

## ***B. Emigracioni dhe Zhvillimi I Shqipërisë***

### ***B.2.2. Fenomeni i ikjes së trurit***

#### ***MASA 54***

Zhvillimi i politikave me qëllim nxitjen e kthimit të emigrantëve të kualifikuar.

#### ***Aktiviteti***

1. Vlerësimi i ofertes dhe kërkeses për personel të kualifikuar, në tregun e punës Shqiptar
2. Krijimi i kontakteve ndërmjet emigrantëve dhe ndërmarrjeve të mëdha në Shqipëri, duke krijuar një bankë të dhenash elektronike me ndërmarrjet dhe CV të emigrantëve.

#### ***Kërkesa paraprake***

Percaktimi duke vendosur kritere të termit emigrant i kualifikuar.

#### ***Institucioni përgjegjës***

MPCS,

#### ***Institucioni Zbatues***

MPCS, MoE.

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1.2005

2. në vazhdimësi

#### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistuese.

#### ***Buxheti në Total***

1. Buxheti ekzistues

2. 10000 Euro

#### ***Treguesit (nëse ka)***

-

#### ***Niveli i zbatimit***

1. E zbatuar

2. E pazbatuar

#### ***Konsiderata***

1. Oferta dhe kërkesa për personel me kualifikim të lartë në tregun shqiptar të punës janë vlerësuar në analizën periodike të tregut të punës.
2. Baza e të dhënave online në lidhje me shoqëri dhe curricula të emigrantëve nuk është krijuar akoma, por MPCSShB po punon për të bërë të mundur realizimin e një aktiviteti të tillë.

### *Rekomandime*

1. MPCSShB duhet të punojë në bashkpunim me METE për projektimin e bazës së të dhënave ;
2. MPCSShB duhet të parashikojë buxhetin e nevojshëm për një aktivitet të tillë në rast të mungesë së ndihmës nga donatorët.

## **MASA 55**

Zhvillimi i politikave me qellim shmangien e largimin te trurit.

### ***Aktiviteti***

Rritja e ofertes per pune ne Shqiperi:

1. Terheqja e investitoreve te huaj qe te investojne ne Shqiperi.
2. Nxitja e investitoreve qe te punesojne staf ne vend, ose nga Diaspora jashte vendit.

### ***Kerkesa paraprake***

Miratimi i Ligjit te ri "Per Nxitjen e punesimit"

### ***Institucioni pergjegjes***

MPCS

### ***Institucioni Zbatues***

MPJ, MPCS, SHKP, ME, Agjensia e SME-ve, NJQV

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2005 –2010

### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistuese.

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti ekzistues.

### ***Treguesit (nëse ka)***

-

### ***Niveli i zbatimit***

E zbatuar

### ***Konsiderata***

Qeveria po pergatit paketen ligjore te nismes "Shqipëria një euro" për të tërhequr investime nga investitorët e huaj.

### ***Rekomandime***

-

## **MASA 56**

Zbatimi i programeve ekzistuese dhe te ardhshme kombetare, apo i programeve te perbashketa me institucione nderkombetare, ne menyre qe te terhiqen emigrantet e kualifikuar per t'I sherbyer Shqiperise.

### ***Aktiviteti***

Vendosja e bashkepunimit me institucionet kombetare dhe nderkombetare per zbatimin e programeve, per shembull me PNUD per te zbatuar TOKTEN ne Shqiperi.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MPCS

### ***Institucioni Zbatues***

MPCS

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2005-2010

### ***Burimet njerezore***

Burimet ekzistuese.

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti ekzistues

### ***Treguesit (nëse ka)***

-

### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

### ***Konsiderata***

MPCSShB nuk ka vendosur akoma asnjë kontakt me institucionet vendas dhe ndërkombëtar për të zbatuar programe për të tërhequr emigrantë me kualifikim të lartë që të punojnë në Shqipëri. Reduktimi i stafit në Drejtorinë e Politikave Migratore është një nga arësyet për mosrealizimin e kësaj mase.

### ***Rekomandime***

1. MPCSShB, në bashkëpunim me DAP duhet të kërkojë të realizojë takime me organizma ndërkombëtar, për të zhvilluar projekte për tërheqjen e emigrantëve të kualifikuar për të punuar në Shqipëri.

## ***C. Përmirësimi i Kuadrit Ligjor për Migracionin në Shqipëri***

### ***MASA 57***

Ratifikimi i Instrumentave Nderkombetare ne Fushen e Migracionit.

### ***Aktiviteti***

Marrja e masave per perfundimin e procedurave te ratifikimit te instrumentave nderkombetare si me poshte:

1. Konventa e Organizates Nderkombetare te Punes Nr. 143 "Per punonjesit migrante".
2. Ratifikimi i Konventes se Keshillit te Evropes "Mbi " Statusin Ligjor te Punonjesve Migrante";
3. Ratifikimi i Konventes se Kombeve te Bashkuara "Per mbrojtjen e te drejtave te te gjithe punonjesve migrante dhe anetareve te familjeve te tyre".

### ***Kerkesa paraprake***

Kryerja e një raporti vleresues mbi ndikimet qe do te kete ratifikimi i Instrumentave Nderkombetare ne Legjislacionin e brendshem.

### ***Institucioni pergjegjes***

MPCS/MPJ

### ***Institucioni Zbatues***

MPCS/MPJ

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. Tetor 2005;
2. Prill 2006;
3. Dhjetor 2006

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Burimet Ekzistuese

### ***Treguesit (nëse ka)***

Ratifikim i Konventave

### ***Niveli i zbatimit***

1. E zbatuar
2. E zbatuar
3. *Jashtë objektit të këtij raporti*

### ***Konsiderata***

Konventa ILO 143 « Mbi punëtorët migrant » dhe konventa e Këshillit të Europës mbi "Statusin ligjor të punëtorëve migrant" janë ratifikuar.

### ***Rekomandime***

-

## **MASA 58**

Miratimi i akteve ligjore te reja dhe ndryshimi akteve ligjore ekzistuese ne fushen e emigracionit per zgjerimin e sferes se mbrojtjes se emigranteve ne perputhje me standartet nderkombetare

### ***Aktiviteti***

1. Miratimi i ndryshimeve te Ligjit Nr. 9034/2003 Per emigrimin e Shtetasve Shqiptare per Motive Punesimi.
2. Perfshirja ne Ligjin per Arsimin Parauniversitar e dispozitave qe parashikojne pergjegjesine e Shtetit Shqiptar per te mundesuar mesimin e gjuhes shqipe te emigranteve dhe familjeve te tyre ne perputhje me Nenin 11(2) te ligjit per Emigrimin e Shtetasve Shqiptare per Motive Punesimi;
3. Kryerja e nje studimi per identifikimin e infrastruktures se nevojshme per votimin jashte vendit te emigranteve shqiptare. Amendimi i Kodit Zgjedhor dhe akteve te tjera ne zbatim te nenit 5(1) te "Ligjit per Emigrimin" per ushtimin e te drejtes se votes jashte vendit per emigrantet shqiptare.  
Ndryshimet perkatese te Ligjit per Sherbimet Konsullore dhe akteve te tjera ne zbatim ne perputhje me ndryshimet e Kodit Zgjedhor.
4. Hartimi dhe Miratimi i akteve nenligjore ne baze dhe zbatim te nenit 13 dhe 14 te Ligjit per Emigrimin-Hartimi dhe miratimi i VKM "Per nxitjen e kthimit vullnetar te emigranteve Shqiptare dhe ri-integrimin e tyre ne vend".
5. Amendimi I Ligjit per Gjendjen Civile dhe Vendimit Nr. 365/2000 " Per krijimin dhe mirembajtjen e regjistrit Kombetar te gjendjes Civile dhe rregullat per perdorimin e teknikes dhe rrjetit informatik" me qellim perfshirjen e kontigjentit te emigranteve ne kete regjister.
6. Miratimi i Ligjit Integral per Nxitjen e Punesimit.
7. Ndryshimi i Ligjit per Sigurimet Shoqerore.

### ***Kerkesa paraprake***

Miratimi i Planit Kombetar te Perafrimit te Legjislacionit me Acquis Communautaire, ku do te perfshihen standartet qe duhet te merren parasysh ne kuader te reformes legjislative.

### ***Institucioni pergjegjes***

- 1.MPCS,
- 2.MASH
- 3.MPCS, MPJ, KQZ
4. MPCS
- 5.MPVD
- 6.MPCS
7. MPCS

### ***Institucioni Zbatues***

- 1.MPCS,
- 2.MASH
- 3.MPCS, MPJ, KQZ

4. MPCS
5. MPVD
6. MPCS
7. MPCS

***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. Dhjetor 2005;
2. 2006;
3. Perfundimi i Studimit 2006-2007. Ndryshimet ligjore dhe sigurimi i infrastruktures se nevojshme-2007-2008.
4. Dhjetor 2006
5. 2006
6. Qershor 2006
7. 2005

***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese

***Buxheti ne Total***

Burimet Ekzistues  
Per Studimin ne piken (4) rreth  
20000 euro.

***Treguesit (nëse ka)***

Ndryshimet perkatese te akteve ligjore dhe nenligjore.

***Niveli i zbatimit***

1. E zbatuar
2. E pazbatuar
3. E pazbatuar
4. E pazbatuar
5. E pazbatuar
6. E zbatuar
7. E zbatuar

***Konsiderata***

1. Eshte aprovuar.
2. MASH nuk ka ndryshuar ligjin. Janë zhvilluar ndërhyrje rast pas rasti.
3. Studimi nuk është realizuar, por në ligjin e ri për emigracionin, miratuar në dhjetor 2006, është përfshirë e drejta e votës për emigrantët. Është në vijim ndryshimi i kodit elektoral, por nuk është akoma e qartë nëse do të përfshihet një dispozitë mbi votën e emigrantëve. Megjithatë, është i dobët vullneti politik për të autorizuar votën e emigrantëve jashtë.
4. Ligji për emigracionin u aprovua në dhjetor 2006. Aktet nënligjor përkatës nuk janë aprovuar akoma.
5. Ligji nuk është ndryshuar

6. Ligji Integral për Nxitjen e Punësimit është aprovuar
7. Është ndryshuar Ligji për Sigurimet shoqërore

***Rekomandime***

1. MASH duhet të krijojë një grup pune të brendshëm për të përgatitur ndryshimet mbi Ligjin e Arsimit parauniversitar ;
2. MPCSShB, MPJ dhe KQZ duhet të bashkëpunojnë për përcaktimin e termave të referencës për studimin mbi identifikimin e strukturave që do të bëjnë të mundur votimin e emigrantëve jashtë;
3. MPCSShB duhet të përshpejtojë procedurat për aprovimin e akteve nenligjor për zbatimin e ligjit të emigracionit ;
4. MB, në bashkëpunim me MPCSShB dhe MPJ, duhet të punojë për ndryshimin e ligjit për gjendjen civile dhe vendimin nr 365 të 2000 “Per krijimin dhe mirembajtjen e regjistrit Kombetar te gjendjes Civile dhe rregullat per perdorimin e teknikes dhe rrjetit informatik” me qellim perfshirjen e kontigjentit te emigranteve ne kete regjister;

## **MASA 59**

Miratimi i akteve ligjore te reja dhe ndryshimi akteve ekzistuese ne fushen e imigracionit me qellim parafrimin me Acquis Communautaire.

### **Aktiviteti**

1. Miratimi i Projekt Ligjit “Per disa Ndryshimeve te Ligjit per te Huajt” ne perputhje me kërkesat e Acquis Evropiane ne fushen e migracionit.
2. Ndryshimi i VKM nr. 439/2000 “Per Hyrjen, qendrimin dhe trajtimin e te huajve ne Republiken e Shqiperise” ne baze dhe ne zbatim te ndryshimeve te Ligjit per te Huajt.
3. Hartimi dhe miratimi i Ndryshimeve te Udhezimit te Perbashket te Ministrit te Puneve te Jashtme dhe Ministrit te Rendit Publik “Per Hyrjen, qendrimin dhe trajtimin e te huajve ne Republiken e Shqiperise”.
4. Hartimi dhe Miratimi i Ndryshimeve te VKM nr. 262/2000 “Per Dhenien e lejes per pune te shtetasve te huaj” ne baze dhe zbatim te Ligjit per te Huajt.
5. Hartimi dhe miratimi i Ndryshimeve te Udhezimit te Ministrit te MPCs Nr, 786/2001 ne baze dhe zbatim te ndryshimeve te VKM -262/2001 dhe Ligjit per te Huajt.
6. Hartimi i akteve ligjore qe do te rregullojne procedurat e ndalimit dhe largimit te te kthyerve.

### **Kerkesa paraprake**

1. Miratimi i Planit Kombetar te Perafrimit te Legjislacionit me Acquis Communautaire, ku do te perfshihen standartet qe duhet te merren parasysht ne kuader te reformes legjislative.
2. Miratimi i Ndryshimeve te Ligjit per te Huajt.
3. Miratimi i Projektligjit per Ndryshime te Ligjit per te Huajt.
4. Miratimi i Projektligjit per Ndryshime ne Ligjin per te Huajt.
5. Miratimi I ProjektLigjit per Ndryshime ne Ligjin per te Huajt.

### **Institucioni pergjegjes**

1. MPCs, MRP, MPJ.
2. MPCs, MRP, MPJ
3. MRP, MPJ
4. MPCs
5. MPCs
6. MRP

### **Institucioni Zbatues**

1. MPCs, MRP, MPJ.
2. MPCs, MRP, MPJ
3. MRP, MPJ
4. MPCs
5. MPCs
6. MRP

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

1. I papercaktuar ne varesi te miratimit ne Parlament.
2. Ne varesi te Miratimit te ndryshimeve te Ligjit per te Huajt.
3. Ne varesi te miratimit te Projektligjit per Ndryshime te Ligjit per te Huajt.
4. 2006 (ne varesi te miratimit te Projektligjit per ndryshime ne Ligjin per te Huajt.
5. Si me siper.
6. 2006

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti Ekzistuese

### ***Treguesit (nëse ka)***

Miratimi i Akteve Ligjore te reja dhe Ndryshimi i atyre ekzistuese.

### ***Niveli i zbatimit***

1. Pjesërisht e zbatuar
2. E pazbatuar
3. E pazbatuar
4. E pazbatuar
5. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

1. Projektligji “Për të huajt” është përgatitur nga MPCSShB në bashkpunim me MB, MPJ dhe MI. Projekti do ti prezantohet institucioneve të tjera vendase dhe ndërkombëtare për komente.
- 2/6 Të gjitha ndryshimet e sipërpërmendura të kuadrit ligjor në fushën e imigracionit varen nga aprovimi i ligjit për të huajt, parashikuar për fundin e 2006.

### ***Rekomandime***

-

## **MASA 60**

Hartimi i manualeve praktike që lidhen me ceshtjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin ne praktike te legjislacionit per Migracionin.

### ***Aktiviteti***

1. Identifikimi i akteve ligjore/nenligjore qe zbatohen ne praktike nga cdo institucion qe merret me te huajt/emigrantet.
2. Pajisja e nepunesve si ne zyrat qendrore dhe ato lokale/rajonale qe merren ne praktike me te huajt/emigrantet me keto manuale shpjeguese.

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

MPCS, MRP, MPJ

### ***Institucioni Zbatues***

MPCS, MRP, MPJ

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

Dhjetor 2006

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ezistuese

### ***Buxheti ne Total***

5.000 euro.

### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i manualeve ne dispozicion tezyrave qendrore, rajonale dhe lokale.

### ***Niveli i zbatimit***

*Jashtë objektit të raportit*

### ***Konsiderata***

-

### ***Rekomandime***

-

## **MASA 61**

Organizimi i trajnimeve te vazhdueshme ne fushen e legjislacionit te brendshem dhe atij nderkombetar per nepunesit qe mbulojne ceshtje te migracionit.

### **Aktiviteti**

1. Identifikimi i nevojave dhe eksperteve qe kane nevoje per trajnime ligjore.
2. Hartimi i moduleve trajnuese ne kete fushe ne bashkepunim me ITAP-in, per perfshirjen e nje moduli te tille ne trajnimet e nepunesve te sherbimit civil.

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni pergjegjes**

ITAP-i.

### **Institucioni Zbatues**

MPCS, MRP, ITAP-i.

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

Janar 2006 ne vazhdim.

### **Burimet njerezore**

Burimet Ekzistuese te ITAP-it

### **Buxheti ne Total**

12.500 euro per 5 vjet (trajnime cdo vit-4 here ne vit).

### **Treguesit (nëse ka)**

Numri i trajnimeve

### **Niveli i zbatimit**

E pazbatuar

### **Konsiderata**

As DAP dhe as ITAP ishin në dijeni për ekzistencën e SKM dhe PKVM. Asnjë aktivitet nuk është programuar për 2006, por ITAP ka vullnetin për të realizuar këtë masë dhe po planifikon të zhvillojë aktivitete trajnimi në 2007-n. Koordinimi dhe bashkpunimi midis ITAP dhe ministrive të linjës, ka munguar. ITAP ka deklaruar se disponon fondet e nevojshme për të realizuar këto trajnime.

### **Rekomandime**

1. ITAP duhet të organizojë takime bilaterale me ministrinë e linjës, në mënyrë që të mbledh informacionet e nevojshme mbi nevojat e tyre në fushën e migracionit;
2. ITAP duhet të përfshijë formimin për migracionin në programin vjetor të punës për 2007;
3. ITAP duhet të punësojë një ekspert për të redaktuar curriculat për trajnimet që duhen zhvilluar.

***D. Organizimi i një strukture të përshtatshme institucionale për të menaxhuar politikën e migracionit, në veçanti për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin***

***MASA 62***

Zgjerimi dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale në nivel qendror, rajonal dhe vendor për menaxhimin e ceshtjeve migratore.

***Aktiviteti***

1. Krijimi i Agjensise Kombëtare të Migracionit, pranë zyrës së Kryeministrit që do të merret me konceptimin dhe kordinimin e politikave për imigracionin, emigracionin dhe Diasporën (Drejtori do të caktohet nga Kryeministri; bordi i Agjensise do të përfshijë përfaqësues nga ministrat që lidhen me zbatimin e politikave, veçanërisht MPCS, MPJ, MRP, MRKS, MPVD, NJQV, ME etj; do të punësohet personel shtesë);
2. Instituti i Diasporës do të zhvendoset nga MPJ, në Agjensinë e përmendur në pikën 1.
3. Zgjerimi i kompetencave të sektorit ekzistues për emigracionin në MPCS që të mbulojë edhe kthimin dhe riintegrimin dhe rekrutimi i personelit shtesë ne Drejtorinë e e Menaxhimit të Kufijve dhe Migracionit.
4. Ngritja e kapaciteteve të Drejtorisë së Menaxhimit të Kufijve dhe Migracionit në MRP duke krijuar sektorin e Te Huajve dhe Sektorin e Kthimit dhe Pranimit.
5. Rekrutimi i burimeve njëzëre njëzëre shtesë për tre sektorët e drejtorisë së Sherbimeve konsullorë në MPJ, me urdher të Kryeministrit.

***Kërkesa paraprake***

-

***Institucioni përgjegjës***

- 1 dhe 2: Kryeministri
- 3: MPCS
- 4: MRP
- 5: MPJ

***Institucioni Zbatues***

- 1 dhe 2: Kryeministri dhe MPJ
- 3: MPCS
- 4: MRP
- 5: MPJ

***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

- 1: 2005/2006
- 2: 2006
- 3: 2006
- 4: 2006
- 5: 2006

### ***Burimet njerëzore***

- 1/2 Te perlllogaritet duke patur parasysh numrin e personave qe do te transferohen nga Instituti ne Agjensi.
3. Punesimi i 4 specialisteve.
4. Punesimi I 4 specialisteve
5. Rekrutimi i pese specialisteve

### ***Buxheti ne Total***

1. Te perlllogaritet.
3. 24 000 Euro ne vit, totali 120 000.
4. 35 000 Euro ne vit (per personelin dhe te tjerat), totali 175 000 Euro.
5. 30 000 Euro ne vit, totali 150 000 Euro.

### ***Treguesit (nëse ka)***

Numri i personave shtese te punesuar.

### ***Niveli i zbatimit***

1. E pazbatuar
2. E pazbatuar
3. E pazbatuar
4. Pjesërisht e zbatuar
5. E pazbatuar

### ***Konsiderata***

1. Edhe pse Qeveria, vendosi të mos krijojë Agjencinë e sipërpërmendur, PKVM nuk është ndryshuar. Megjithatë, me VKM 194 të 5 prillit 2006 Qeveria vendosi krijimin e IKD, duke e mbajtur këtë të fundit në të njëjtin pozicion hierarkik të institutit ekzistues, d.m.th në varesi te Ministrit te Puneve te Jashtme. Këtij Instituti ju njohën kompetenca kryesisht për diasporën dhe për emigracionin. Në këtë mënyrë, është “tradhëtuar” natyra e kësaj mase, në radhë të parë për pozicionin hierarkik që ish menduar në fillim për Agjencinë. Në fakt, ishte parashikuar që kjo agjenci të varej nga zyra e Kryeministrit, pra si një organizëm super partes, ndërsa IKD mbetet në varesi te Ministrit te Puneve te Jashtme d.m.th në të njëjtin nivel me ministritë e tjera. Për sa i takon kompetencave të IKD, duket se këto, janë më të reduktuara dhe në kontrast me PKVM. Së fundi, nga këndvështrimi i burimeve njerëzore, stafi i IKD është reduktuar në vend që të rritej. Nga ana tjetër, Bordi i IKD nuk është krijuar ende dhe nuk ekziston aktualisht një bashkpunim real midis IKD dhe ministrive të tjera. Përveç kësaj, në praktikë IKD nuk njeh kompetencën e tij mbi çështje të ndryshme nga ajo e diasporës. Është shqetësues fakti që një vendim i tillë i Qeverisë, nuk mori në konsideratë SKM dhe PKVM.
2. Lexo konsideratën e sipërpërmendur
3. Eshte suprimuar sektori i emigrimit ne MPCSShB (nje specialist i nivelit te trete).
4. Një sektor i ri është krijuar dhe shtimi i burimeve njerzore është planifikuar për 2007.

5. Në asnjë nga tre sektorët e Drejtorisë së Shërbimeve Konsullore në MPJ nuk janë punësuar personel shtesë.

### ***Rekomandime***

1. KNM duhet ose të modifikojë PKVM, duke reflektuar në të përmbajtjen e VKM 194 data 5.4.2006 ose do të duhet të bëjë të mundur që kompetenca, autoriteti dhe burimet njerzore të Agjencisë së parashikuar ti transferohen të sapokrijuarit IKD;
2. IKD duhet të transferohet nën autoritetin e Kryeministrit
3. IKD duhet të përshpejtojë procedurat për krijimin e Bordit të tij.
4. MPCSShB në bashkpunim me DAP, duhet të konsiderojë zgjerimin e kompetencave në sektorin ekzistues të emigracionit edhe me rikthimet dhe riintegrimet, sikurse punësimin e burimeve njerzore shtesë në Drejtorinë e Migracionit;
5. MPJ, në bashkpunim me DAP, duhet të përgatisë përshkrimin e punës për stafin e ri në tre sektorët e Drejtorisë së Shërbimeve Konsullore dhe të parashikojë buxhetin e nevojshëm për këtë.

### **MASA 63**

Ngritja e kapaciteteve ne lidhje me keshillimin ligjor ne drejtorite qe merren me migracionin ne MPCSShB, MRP, MPJ.

#### ***Aktiviteti***

Rekrutimi i nje personi te specializuar ne ligjin per migracionin ne secilen nga drejtorite qe merren me migracionin.

#### ***Kerkesa paraprake***

-

#### ***Institucioni pergjegjes***

MPCSShB, MPJ, MRP.

#### ***Institucioni Zbatues***

MPCSShB, MPJ, MRP.

#### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2006

#### ***Burimet njerezore***

3 eksperte ligjore.

#### ***Buxheti ne Total***

90 000 Euro

#### ***Treguesit (nëse ka)***

3 persona shtese.

#### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

#### ***Konsiderata***

Në ministri të ndryshme, politika e Qeverisë është orientuar drejt reduktimit të personelit, më tepër sesa shtimit të tij. Vetëm Drejtoria e Policisë së Kufirit dhe Migracionit ka tashmë programuar dhe aprovuar në parim, punësimin e një juristi të specializuar në të drejtën e migracionit të brendshëm dhe ndërkombëtar, që me siguri do të nis të punojë duke filluar nga janari 2007. Asnjë shtesë tjetër personeli është verifikuar në dy ministrinë e tjera, MPCSShB dhe MPJ.

#### ***Rekomandime***

1. MPCSShB dhe MPJ duhet të parashikojnë buxhetin e nevojshëm për të mbuluar pozicionin e ri, me një person të specializuar në të drejtën migratore;
2. Të dyja këto ministri, në bashkpunim me DAP duhet të përcaktojnë përshkrimin e punës për stafin e ri që do të punësohet.

## **MASA 64**

Permirosimi i njohurive dhe specializim ne fushat e emigracionit dhe imigracionit.

### ***Aktiviteti***

Krijimi i kurseve te pergjithshme per emigracionin dhe i kurseve specifike per ligjin mbi imigracionin qe te perfshijne gjithashtu Legjislacionin Shqiptar dhe European per imigracionin. Perfshirja e ketyre kurseve ne programet e universiteteve kryesore shqiptare

### ***Kerkesa paraprake***

Trainimi i profesoreve.

### ***Institucioni pergjegjes***

MASH

### ***Institucioni Zbatues***

MASH, Universitet

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

2006

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese.

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti Ekzistues.

### ***Treguesit (nëse ka)***

-

### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Drejtoria kompetente e MASH, nuk ishte në dijeni të ekzistencës së SKM, për pasojë edhe të këtij aktiviteti. Për këtë arsye, asgjë nuk është bërë në këtë fushë.

### ***Rekomandime***

1. MASH duhet të krijojë një Komision për Curriculat për çështjet migratore për zhvillimin e kurseve të përgjithshme mbi emigracionin dhe kurse të specializuar mbi të drejtën e imigracionit. Komisioni në fjalë, mund të përbëhet nga profesorë dhe përfaqësues të MASH, MPJ dhe MPCSShB.

## **MASA 65**

Monitorimi i Planit Kombetar te Veprimit.

### ***Aktiviteti***

Monitorim i vazhdueshem cdo 6 muaj dhe raportim perfundimtar perpara Komitetit Nderministerial per Migracionin, ne fund te vitit 2010 per perparimin dhe vonesat ne zbatimin e Planit Kombetar te Veprimit te Migracionit .

### ***Kerkesa paraprake***

-

### ***Institucioni pergjegjes***

Kryeministri

### ***Institucioni Zbatues***

Instituti per Diasporen dhe Migracionin.

### ***Afati (Kohezgjatja Finalizimi)***

Raporti i pare ne fund te vitit 2005 dhe me pas ne fund te cdo gjashtemujori.

### ***Burimet njerezore***

Burimet Ekzistuese

### ***Buxheti ne Total***

Buxheti Ekzistues.

### ***Treguesit (nëse ka)***

9 raporte cdo 6 muaj dhe nje perfundimtar.

### ***Niveli i zbatimit***

E pazbatuar

### ***Konsiderata***

Asnjë institucion nuk është ngarkuar zyrtarisht me detyrën për të monitoruar zbatimin e PKVM. Institucioni, që në perspektivën e politikës së Qeverisë së re, ka zyrtarisht zëvendësuar Agjencinë e parashikuar për migracionin, IKD, do të duhej të ishte i ngarkuar edhe me monitorimin e zbatimit të PKVM. Në të kundërt, vendimi që krijoi këtë institut, midis kompetencave të tij nuk ka përmendur funksionin e monitorimit. Pra, asnjë raport mbi zbatimin e PKVM është realizuar ndonjëherë. Ekspertët konsiderojnë se, gjendja aktuale e prapambetjes në zbatimin e strategjisë do të mund të evitohet nëse një organizëm i tillë monitories të ish krijuar në kohë.

### ***Rekomandime***

1. KNM, i kryesuar nga zv/Kryeministri, duhet të identifikojë sa më parë organizmin kompetent për monitorimin e zbatimit të PKVM;

2. Deri sa Qeveria Shqiptare të zgjedh dhe të vendosë organizmin që do të kryej këtë funksion, nisur nga kompetencat në këtë fushë dhe punën e bërë deri tani, ekspertët mendojnë se MPCSShB i ka mundësitë për të realizuar një aktivitet të tillë. Në një rast të tillë, kjo ministri dhe në vecanti Drejtoria e Politikave të Migracionit, do të ketë nevojë të mbështetet në burime shtese financiare e njerzore.

## **MASA 66**

Administrimi i nje rrjeti elektronik per studiuesit e huaj dhe Shqiptare te specializuar ne fushen e migracionit nga dhe me ane te nepunesve te ministrive qe merren me politikat e imigracionit, migracionit dhe diaposres.

### **Aktiviteti**

Plotesimi i faqes se internetit me emrat dhe detajet e nepunesve te te gjitha ministrive qe merren me politikat per emigracionin dhe imigracionin

### **Kerkesa paraprake**

-

### **Institucioni pergjegjes**

Instituti per Diasporen dhe Migracionin.

### **Institucioni Zbatues**

Te gjitha ministrive qe merren me imigracionin emigracionin dhe diasporen

### **Afati (Kohezgjatja Finalizimi)**

Fundi i vitit 2005.

### **Burimet njerezore**

Burimet Ekzistuese

### **Buxheti ne Total**

Buxheti Ekzistues.

### **Treguesit (nëse ka)**

Numri i personave te kontaktit te paraqitur ne faqen e internetit.

### **Niveli i zbatimit**

E pazbatuar

### **Konsiderata**

Moskrijimi i Agjencisë Kombëtare për Migracionin, ka krijuar një boshllëk për këtë masë, që gjendet pa një organizëm përgjegjës. Në fakt, i sapokrijuari IKD nuk është zyrtarisht i ngarkuar me zbatimin e kësaj mase, në mënyrë të vecantë, duke konsideruar se aktiviteti i parashikuar nuk përfshihet në sferën e tij të kompetencës.

### **Rekomandime**

1. KNM duhet të identifikojë organizmin kompetent për zbatimin e kësaj mase. Ekspertët mendojnë se, MPCSSHb i ka mundësitë për të realizuar një aktivitet të tillë. Në një rast të tillë kjo ministri dhe në vecanti Drejtoria e Politikave të Migracionit do të ketë nevojë të mbështetet në burime shtese financiare e njerzore.

## REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

1. Në përfundim të monitorimit të zbatimit të PKVM dhe për pasojë edhe të SKM, në zbatim të të cilës ai është ndërtuar, mund të pranohet si konkluzion i përgjithshëm se, realizimi i masave të parashikuara në këtë dokument ka qenë i dobët. Faktorët që kanë ndikuar në këtë rezultat kanë qenë, pa dyshim, të shumtë e të shumëllojshëm. Por, pavarësisht nga natyra e tyre apo intensiteti i ndikimit mbi rezultatin, një gjë është fakt: ky i fundit, duke qenë migracioni një nga fenomenet më të rëndësishme dhe më të mprehta për shoqërinë Shqiptare dhe për këtë arsye edhe një nga politikat publike më sensibil, nuk mund të mos e shqetësojë qytetarin Shqiptar për këtë performancë të ulët. Dhe jo vetëm kaq, për shkak të natyrës së tij komplekse dhe implikimeve të drejtpërdrejta ose indirekte në shumë fusha, migracioni përbën, përveç të tjerave, një fenomen tepër të ndjeshëm edhe për vendet e tjera Europiane, pavarësisht nga largësia gjeografike me Shqipërinë, duke u shndërruar, kështu, në një nga pikat e “nxehta” të marrëdhënies sonë me Bashkimin Europian;
2. Shkaku kryesor që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në nivelin e zbatimit, ka qenë, mungesa e një vullneti të qartë lidhur me zbatimin e dokumentave kryesor strategjik në këtë fushë dhe pikërisht SKM dhe PKVM;
3. Kështu, KNM, që mbetet një organ i një rëndësie të madhe për fushën, nuk është mbledhur asnjëherë që pas miratimit të PKVM-maj 2005, ndërkohë që kjo duhet të ndodhë jo më pak se një herë në gjashtë muaj;
4. Një situatë e tillë, shoqëruar me ndryshimet e mëdha në strukturën e Qeverisë (bashkime Ministrish, eliminimi i Ministrisë të Shtetit, ndryshime strukturash, zvogëlime stafesh, rekrutim funksionarësh të rinj etj, etj), ndryshime që prekën edhe strukturat apo stafet që ishin marrë me përpunimin e këtyre dokumenteve, solli si rezultat paqartësi ndaj zbatimit të masave të parashikuara në PKVM dhe sic ishte rasti në pothuajse gjysmën e institucioneve që ishin përfshirë në këtë proces, mungesë dijenie totale për ekzistencën e tyre dhe në ndonjë rast injorim i qëllimshëm i tyre, si produkte të një qeverie tjetër, duke vënë kështu, në pikëpyetje serioze parimin e rëndësishëm kushtetues të vazhdimësis së shtetit;
5. Vendimet e marra në këtë periudhë nga Qeveria, sidomos ato më kryesorët e shtuan më shumë paqartësinë e qëndrimit ndaj këtyre dokumenteve. Kështu, nisur nga qëllimi kryesor i SKM, i cili është pajisja e Shtetit Shqiptar me një mekanizëm menaxhues të fenomenit migrator, elementët kryesor ku do të vihej theksi do të ishin ata të politikbërjes, koordinimit dhe monitorimit. Në këtë drejtim, sipas PKVM, pritej krijimi i Institutit apo Agjencisë Kombëtare për Diasporën dhe Migracionin pranë zyrës së Kryeministrit, i cili do të luante rolin e liderit në procesin e zbatimit të PKVM, pikërisht duke u pajisur me kompetenca të plota në drejtimet e sipërpërmendura. Ky vendim u mor nga qeveria, por me përmbajtje të ndryshme nga ajo cka ishte parashikuar në PKVM. IKD do të

vazhdojë të jetë nën varësinë e MPJ, pra në të njëjtin rrafsh hierarkik me të gjithë institucionet e tjera, i pajisur vetëm me kompetenca politikbërjeje edhe pse struktura e tij, tërësisht e lidhur me problemet e diasporas, nuk ia bënë të mundur realizimin e kësaj detyre, si dhe të vlerësojë përputhshmërinë e SKM me strategjitë e tjera edhe kjo e pamundur për mungesë stafi dhe eksperience në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, ky vendim edhe pse në kundërshtim me frymën e PKVM, nuk u shoqërua me ndryshim edhe të këtij të fundit, duke krijuar një situatë bllokimi për procesin;

6. Në këto kushte, nuk ekziston në Shtetin Shqiptar një organ apo institucion lider në procesin e zbatimit të SKM dhe PKVM (sic parashikohej në PKVM), i cili të realizojë koordinimin dhe monitorimin e këtij procesi. Këto dy drejtime, jetike për suksesin e kësaj politike, janë aktualisht, plotësisht të zbuluara;
7. Po kështu, gjatë këtyre viteve, politika e reduktimit të shpenzimeve dhe e një administrate të vogël edhe pse pozitive në thelb, ishte në kontrast të hapur me shumë nga masat e parashikuara në PKVM, zbatimi i të cilave kërkonte fuqizim dhe rritje kapacitetesh dhe shtim të burimeve financiare. Zbatimi i një politike të tillë, kërkon, në mënyrë të vecantë, një kujdes dhe vigjilencë të madhe ndaj efikasitetit të administratës dhe strukturave të saj, gjë që nuk ka ndodhur në rastin konkret. Një pjesë e masave apo aktiviteteve të parashikuara në PKVM nuk janë përfshirë në programet vjetor të punës dhe gjithashtu, nuk janë parashikuar në buxhetin e shtetit për institucionet përkatëse;
8. Si konkluzion, mund të themi se edhe pse të padeklaruar, për asnjë moment, si të pavlefshëm nga Qeveria Shqiptare, SKM dhe PKVM janë gjendur, përgjatë procesit të zbatimit të tyre, nën ndikimin e forte, negativ të dy faktorëve vendimtarë; nga njëra anë, zbatimi i tyre, i kundërt me frymën e këtyre dokumenteve, në mënyrë të vecantë rasti i IKD e la këtë proces pa koordinim dhe monitorim dhe nga ana tjetër, politika reduktuese e Qeverisë e cila, jo vetëm nuk i fuqizoi kapacitetet e kërkuara por, në disa raste, i zvogëloi ata në mënyrë drastike, qoftë për sa i takon burimeve financiare, ashtu edhe ato njerzore. Në këto kushte, ekspertët e konsiderojnë me vend të rekomandojnë:
9. Mbajtjen e një qëndrimi të qartë të Qeverisë Shqiptare lidhur me të ardhmen e zbatimit të SKM dhe PKVM dhe ndaj përmbajtjes së tyre, qëndrim ky, që i duhet bërë të ditur të gjitha institucioneve apo organizmave që, direkt ose indirect, janë përfshirë në këtë proces. Në mënyrë të vecantë, ky qëndrim i duhet deklaruar donatorëve që investuan financiarisht dhe teknikisht në përgatitjen dhe përpunimin e dy dokumenteve të sipërpërmendur dhe që, sic është rasti për Komisionin Europian, kanë parashikuar fonde të konsiderueshme, pikërisht për zbatimin e tyre;
10. Duhet të fillojë të rimblidhet rregullisht KNM, si organ këshillimor i KM, pasi në kushtet aktuale, në nivel hierarkik, është organi më i lartë që kujdeset për mbarvajtjen e trajtimit të fenomenit migrator në Shqipëri;

11. Qeveria duhet të përcaktojë, sa më parë të jetë e mundur, institucionin apo institucionet, të cilët do të realizojnë koordinimin dhe monitorimin e procesit të zbatimit të PKVM, rrjedhimisht të SKM.
12. Deri atëherë, nisur nga vetë funksioni, kompetencat dhe ekspertiza e madhe në këtë fushë, ekspertët mendojnë se ky rol mund ti jepet MPCSShB. Në këtë kuadër, është logjike që të jetë po kjo ministri që të ketë kompetencën ekskluzive edhe në politikbërje në fushën e migracionit dhe përafrimin e strategjive të ndryshme me SKM. Në këto kushte, IKD duhet ti mbetet roli ekskluziv në çështjet dhe problematikat që kanë të bëjnë me Diasporën;
13. Për sa më sipër, nevojitet ndryshim i VKM nr 194, datë 5.4.2006 “Për ngritjen dhe funksionimin e Institutit Kombëtar të Diasporës, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë” ndryshim i cili, do të reflektojë rekomandimin e prezantuar në pikën 12. Gjithashtu, po në këtë drejtim, duhet të fuqizohen kapacitetet njerzore dhe financiare të Drejtorisë së Politikave të Migracionit në MPCSShB. Ndryshimet e mësipërme, janë në përputhje me frymën e SKM dhe PKVM, në qëndër të vëmendjes të të cilëve është identifikimi dhe pajisja me kompetenca të plota politikbërjeje, koordinimi dhe monitorimi i një institucioni lider, që do të mendojë, udhëheqë dhe monitorojë procesin kompleks, shumëdisiplinor të zbatimit të SKM dhe PKVM;
14. Në të njëjtën kohë dhe në përputhje të plotë me kërkesën e BE-së, për respektimin e kriterëve të saj për disbursimin e fondeve të miratuara nga Programet CARDS 2004, 2005, Qeveria Shqiptare duhet të planifikojë në buxhetin e shtetit fondet e nevojshme financiare për realizimin e masave të parashikuara nga PKVM për cdo institucion të përfshirë në këtë proces;
15. Duhet studiuar me kujdes raporti administratë e vogël-eficencë dhe në këtë kuadër, të rishikohet qëndrimi ndaj çështjes së kapaciteteve njerzore, sidomos, në disa nga strukturat kryesore në procesin e zbatimit të PKVM, si p.sh IKD dhe Drejtoria e Shqërbimeve Konsullore dhe Vizave në MPJ, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit në MB;
16. Dhe së fundi, duhet punuar për rritjen e bashkpunimit me organizmat dhe institucionet ndërkombëtare, shoqërinë civile për sigurimin në vazhdimësi të mbështetjes financiare e teknike, aq të nevojshme në realizimin me sukses të një procesi të tillë;
17. Si përfundim, duhet pranuar se këto dokumente, si SKM, ashtu edhe PKVM, janë që të dy tepër kompleks, pasi trajtojnë në mënyrë shumëdisiplinore një fenomen po kaq kompleks, sic është ai i migracionit. Është e vërtetë, Shteti Shqiptar nuk ka një përvojë të gjatë në përpunimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjik të tillë, gjë që ndihet edhe në rastin tonë. Por megjithatë, e rëndësishme është të ekzistojë vullneti i duhur dhe vendosmëria për realizimin e tyre, pasi, në fund të fundit,

sforcot që kërkon një gjë e tillë janë, pa asnjë dyshim, shumë herë më të vogla se përfitimet e nxjerra për qytetarin, shoqërinë dhe Shtetin Shqiptar, nëse, në fund të fundit, bëhet e mundur shndërrimi i kësaj plage shoqërore, në një instrument të mirëfillt e avantazhues zhvillimi.

## **TABELA E SHKURTIMEVE**

|                |   |
|----------------|---|
| <b>AP</b>      | <b>Avokati i Popullit</b>   |
| <b>BE</b>      | <b>Bashkimi European</b>  |
| <b>CARDS</b>   | <b>Asistencë Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim</b>    |
| <b>IET</b>     | <b>Instituti European i Tiranës</b>                                   |
| <b>ITAP</b>    | <b>Instituti i Trajnimit të Administratës Publike</b>                 |
| <b>INSTAT</b>  | <b>Instituti i Statistikave</b>                                       |
| <b>ISSH</b>    | <b>Instituti i Sigurimeve Shoqërore</b>                               |
| <b>IOM</b>     | <b>Organizata Ndërkombëtare për Migracionin</b>                       |
| <b>IKD</b>     | <b>Instituti Kombëtar për Diasporën</b>                               |
| <b>KNM</b>     | <b>Komiteti Ndërministror për Migracionin</b>                         |
| <b>KM</b>      | <b>Këshilli i Ministrave</b>  |
| <b>KQZ</b>     | <b>Komisioni Qëndror Zgjedhor</b>                                     |
| <b>MPCSSHB</b> | <b>Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta</b> |
| <b>MBUMK</b>   | <b>Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit</b>  |
| <b>METE</b>    | <b>Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës</b>               |
| <b>MPJ</b>     | <b>Ministria e Punëve të Jashtme</b>                                  |
| <b>MB</b>      | <b>Ministria e Brendshme</b>  |
| <b>MASH</b>    | <b>Ministria e Arsimit dhe Shkencës</b>                               |
| <b>MTKRS</b>   | <b>Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</b>            |
| <b>MPPTT</b>   | <b>Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit</b> |
| <b>MIE</b>     | <b>Ministria e Integritimit European</b>                              |
| <b>MSA</b>     | <b>Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit</b>                              |

|              |   |
|--------------|---|
| <b>PNUD</b>  | <b>Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin</b> |
| <b>PKVM</b>  | <b>Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin</b>      |
| <b>RTVSH</b> | <b>Radio Televizioni Shqiptar</b>                     |
| <b>SKM</b>   | <b>Strategjia Kombëtare për Migracionin</b>           |
| <b>SHKP</b>  | <b>Shërbimi Kombëtar i Punësimit</b>                  |
| <b>SHSSH</b> | <b>Shërbimi Social Shtetëror</b>                      |